



BANKA QENDRORE E REPUBLIKES SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

RAPORTI I ZHVILLIMEVE MAKROEKONOMIKE

Numër | **3**
Gusht | **2015**

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Raporti i Zhvillimeve Makroekonomike

Numër 3

BOTUES	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës © Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Stabilitetit Financiar 33 Garibaldi, Prishtinë 10000 Tel: ++381 38 222 243 Fax: ++381 38 243 763
FAQJA E INTERNETIT	www.bqk-kos.org
ADRESA ELEKTRONIKE	economic.analysis@bqk-kos.org ;
KRYEREDAKTOR	Arben MUSTAFA
AUTORË	Zana GJOCAJ Bejtush KIÇMARI
REDAKTOR TEKNIK	Butrint BOJAJ
SHTOJCA STATISTIKORE:	Departamenti i Statistikave
VËREJTJE:	Përdoruesit e këtyre të dhënave kërkohen të citojnë burimin. Citimi i sugjeruar: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (2015), Raporti i Zhvillimeve Makroekonomike Nr. 3, Prishtinë. Çdo korigjim i nevojshëm bëhet në versionin elektronik.

SHKURTESAT

ALL	Leku Shqiptar (<i>angl: Albanian Lek</i>)
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
BQE	Banka Qendrore Evropiane
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CEFTA	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë me Shtetet e Evropës Juglindore (<i>angl: Central European Free Trade Agreement</i>)
CHF	Franku Zvicerran (<i>angl: Swiss Frank</i>)
CPI	Indeksi i Çmimeve të Konsumatorit (<i>angl: Consumer Price Index</i>)
DST	Drejttat Speciale të Tërheqjes
EJL	Evropa Juglindore
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian mbi Sundimin e Ligjit (<i>angl: European Union Rule of Law Mission</i>)
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IFO	Instituti për Hulumtime Ekonomike
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IPI	Indeksi i Çmimeve të Importit (<i>angl: Import Price Index</i>)
IPI	Indeksi i Çmimeve të Importit (<i>angl: Import Price Index</i>)
KFOR	Forca Ushtarake e NATO-së në Kosovë (<i>angl: NATO-led Kosovo Force</i>)
MKD	Denari Maqedon (<i>angl: Macedonian Denar</i>)
NPL	Kreditë jo Përfomuese (<i>angl: Non-performing Loans</i>)
OPEC	Organizata e Vendeve për Eksportin e Naftës (<i>angl: Organization of Petroleum Exporting Countries</i>)
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
PNI	Pozicioni Ndërkombëtar i Investimeve
PPI	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit (<i>angl: Producer Price Index</i>)
REER	Norma Reale Efektive e Këmbimit (<i>angl: Real Effective Exchange Rate</i>)

SIMBOLET KONVENCIONALE

"—"	dukuria nuk ekziston
". "	dukuria ekziston, të dhënat nuk janë në dispozicion
"..."	zero ose afër zeros
(e)	e vlerësuar
(p)	preliminare
(r)	e reviduar

PËRMBAJTJA

1. Përmbledhje Ekzekutive-----	10
2. Ekonomia e Eurozonës dhe e Ballkanit Perëndimor -----	14
3. Çmimet e mallrave kryesore në tregjet ndërkombëtare-----	17
3.1. Çmimet e naftës -----	17
4. Ekonomia e Kosovës-----	20
4.1. Produkti i brendshëm bruto-----	20
4.2. Çmimet -----	21
4.3. Zhvillimet Sektoriale -----	26
5. Sektori fiskal-----	29
5.1. Të hyrat buxhetore-----	30
5.2. Shpenzimet buxhetore -----	31
5.3. Borxhi publik-----	32
6. Sistemi financiar -----	34
7. Sektori i jashtëm-----	37
7.1 Llogaria rrjedhëse dhe llogaria kapitale -----	37
7.2. Llogaria financiare -----	43
7.3. Pozicioni ndërkombëtar i investimeve-----	46
7.4. Borxhi i jashtëm -----	47
8. Parashikimet makroekonomike për vitin 2015 -----	49
8.1. Produkti i brendshëm bruto-----	49
8.2. Sektori fiskal-----	50
8.3. Sektori bankar -----	51
8.4. Sektori i jashtëm-----	51
9. Shtojca statistikore-----	53
10. Referencat-----	73

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Norma e kreditimit ndërbankar EURIBOR dhe norma e rifinancimit e ECB-së.....	14
Figura 2. Çmimi i naftës "brent crude" për barel	17
Figura 3. Çmimi i arit, në USD për unce	18
Figura 4. Indeksi i çmimeve të metaleve dhe mineraleve.....	18
Figura 5. Indeksi i çmimeve të ushqimit dhe indeksi i çmimeve të drithrave	19
Figura 6. Rritja reale e PBB-së	20
Figura 7. Komponentat kryesore të PBB-së, vlera nominale, në miliardë euro.....	20
Figura 8. Inflacioni dhe kontribuesit kryesor të tij, rritja vjetore në përqindje	21
Figura 9. Indeksi i çmimeve të duhanit dhe akciza në duhan në euro.....	22
Figura 10. Çmimet e ushqimit dhe kategoritë kryesore të tijë, rritja vjetore në përqindje.....	22
Figura 11. Çmimet e strehimit, ujit dhe energjisë, rritja vjetore në përqindje.....	22
Figura 12. Indeksi i çmimit të energjisë dhe çmimi për KWh.....	23
Figura 13. Çmimet e shërbimeve, rritja vjetore në përqindje	23
Figura 14. Inflacioni i përgjithshëm dhe inflacioni bazë, rritja vjetore në përqindje	24
Figura 15. Komponentët e tregtueshëm dhe të patregtueshëm të IÇK-së.....	24
Figura 16. Indekset e komponentëve të tregtueshëm dhe të patregtueshëm	25
Figura 17. Indekset e çmimeve të konsumit, prodhimit dhe importit.....	25
Figura 18. Prodhimi, konsumi dhe bilanci i energjisë (Giga watt për orë)	26
Figura 19. Konsumi i energjisë sipas përdoruesit të fundit	26
Figura 20. Transporti ajror në Kosovë	27
Figura 21. Indeksi i qarkullimit industrial	27
Figura 22. Regjistri i bizneseve, jo kumulative	28
Figura 23. Struktura e ndërmarrjeve të reja	28
Figura 24. Të hyrat dhe shpenzimet buxhetore, në milionë euro	29
Figura 25. Treguesit kryesor fiskal të EJL-së në vitin 2014 si përqindje e PBB-së	29
Figura 26. Struktura e të hyrave buxhetor, në milionë euro.....	30
Figura 27. Të hyrat vendore neto sipas llojeve kryesore të tatimeve, në milionë euro.....	30
Figura 28. Të hyrat kufitare neto sipas llojeve të tatimeve, në milionë euro.....	31
Figura 29. Struktura e shpenzimeve buxhetore, në milionë euro	31
Figura 30. Borxhi publik, në milionë euro.....	32
Figura 31. Norma e rritjes së kredive sipas sektorëve, në përqindje.....	34
Figura 32. Trendi i rritjes së kredive sipas sektorëve ekonomik, në përqindje	35
Figura 34. Treguesit e profitabilitetit.....	35
Figura 33. Mesatarja vjetore e normave të interesit, në përqindje.....	35
Figura 35. NPL-të dhe provizionet	36

Figura 36. Bilanci i llogarisë rrjedhëse, në milionë euro	37
Figura 37. Importet, eksportet dhe bilanci tregtar, jo kumulative në milionë euro	38
Figura 38. Gjithsej eksportet (jo kumulative) dhe çmimet ndërkombëtare të metaleve.....	38
Figura 39. Struktura e eksporteve sipas kategorive, në përqindje.....	39
Figura 40. Gjithsej importet (jo kumulative) dhe çmimet ndërkombëtare të naftës dhe ushqimit	39
Figura 41. Struktura e importeve sipas kategorive, në përqindje	39
Figura 42. Struktura e eksporteve dhe importeve sipas shteteve, në përqindje.....	40
Figura 43. Struktura e neto eksportit të shërbimeve, në milionë euro	40
Figura 44. Të ardhurat parësore, në milionë euro	41
Figura 45. Të ardhurat dytësore, në milionë euro.....	42
Figura 46. Pranimet e remitencave	42
Figura 47. Investimet e huaja direkte, në milionë euro	43
Figura 48. IHD-të sipas aktiviteteve kryesore ekonomike, në milionë euro.....	44
Figura 49. Investimet e huaja direkte sipas formës së investimit, në milionë euro.....	44
Figura 50. IHD sipas shteteve kryesore, në milionë euro	45
Figura 51. Kreditë tregtare dhe importet, në milionë euro	45
Figura 52. Pozicioni ndërkombëtar i investimeve, në miliardë euro	46
Figura 53. Pozicioni ndërkombëtar i investimeve neto sipas sektorëve institucional, në miliardë euro	46
Figura 54. Borxhi i jashtëm bruto, në milionë euro	47
Figura 55. Borxhi i jashtëm bruto sipas sektorëve, në milionë euro	47
Figura 56. Rritja reale e PBB-së, kërkesa e brendshme dhe e jashtme, në përqindje.....	49
Figura 57. Rritja reale e PBB-së dhe kontribuesit në rritje, në përqindje.....	49
Figura 58. Të hyrat dhe shpenzimet primare buxhetore, në milionë euro	50
Figura 59. Depozitat e sektorit privat dhe PBB-ja reale.....	51
Figura 60. Kreditimi ndaj sektorit privat dhe PBB-ja reale	51
Figura 61. Llogaria rrjedhëse, në milionë euro	51
Figura 62. Eksorti dhe importi i mallrave, në milionë euro.....	52

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Struktura e IÇK-së.....	24
Tabela 2. Llogaria financiare në milionë euro	43

1. Përmbledhje Ekzekutive

Aktiviteti ekonomik në nivel global gjatë vitit 2014 u zhvillua në një ambient më të lehtësuar makroekonomik. Ekonomia e eurozonës filloi rikuperimin ekonomik me gjithë pasiguritë për pasojat eventuale të problemeve në Greqi. Përkundër rikuperimit gradual të aktivitetit ekonomik, i shoqëruar me përmirësimin e besueshmërisë së konsumatorëve dhe përmirësimin gradual të kushteve në tregun e punës, eurozona u karakterizua me rënie të normës së inflacionit gjatë vitit 2014, duke ngritur kështu shqetësimet rreth mundësisë së hyrjes në një periudhë deflacioni.

Në anën tjetër, rajoni i Ballkanit Perëndimor gjatë vitit 2014 u karakterizua me rritje më të dobët ekonomike krahasuar me vitin paraprak. Norma mesatare e rritjes ekonomike për vendet e Ballkanit Perëndimor në vitin 2014 ishte 1.5 përqind, krahasuar me rritjen vjetore prej 2.6 përqind në vitin 2013. Shkalla e ulët e inflacionit në nivel global është reflektuar edhe në ekonominë e Ballkanit Perëndimor, duke ndikuar që norma mesatare e inflacionit të jetë më e ulët krahasuar me vitin paraprak.

Kosova gjatë vitit 2014 u karakterizua me normë pozitive të rritjes ekonomike, mirëpo sikurse vendet e rajonit, edhe ekonomia e Kosovës u karakterizua me normë më të ulët të rritjes krahasuar me vitin paraprak. Norma reale e rritjes ekonomike në Kosovë gjatë vitit 2014, sipas vlerësimeve preliminare të ASK-së ishte 0.9 përqind, përderisa publikimi i vlerësimit zyrtar të PBB-së për vitin 2014 pritet të bëhet nga ASK-ja në nëntor të vitit 2015. Bazuar në vlerësimin e ASK-së, rritja ekonomike në vitin 2014 ishte rezultat i rritjes së konsumit dhe investimeve, përderisa neto eksportet vlerësohet të kenë ndikuar negativisht rritjen ekonomike. Vlerësimet e BQK-së megjithatë sugjerojnë se rritja ekonomike në vitin 2014 ishte më e lartë se 0.9 përqind. Dallimi kryesor ndërmjet vlerësimit të BQK-së dhe vlerësimit të ASK-së për rritjen ekonomike qëndron te vlerësimi i BQK-së për rritje më të lartë të konsumit gjatë vitit 2014. Burime të rëndësishme të financimit të konsumit, siç janë kreditë e reja konsumuese, remitencat, pagat e sektorit publik dhe pensionet, kanë shënuar rritje të konsiderueshme gjatë vitit 2014 dhe kjo vlerësohet të ketë ndikuar në rritjen e të ardhurave të disponueshme dhe, rrjedhimisht, në rritjen e konsumit. Sa i përket investimeve, BQK-ja vlerëson se investimet në vitin 2014 u karakterizuan me rënie prej 7.6 përqind. Kjo rënie e investimeve kryesisht i atribuohet zvogëlimit të shpenzimeve për investime publike, përderisa investimet e sektorit privat regjistruan një rritje të lehtë. Pozicioni i neto eksportit gjatë vitit 2014 kishte ndikim negativ në rritjen ekonomike.

Përkundër rritjes së konsumit, inflacioni është karakterizuar me rënie gjatë vitit 2014. Kjo rënie e shkallës së inflacionit është kryesisht rezultat i zvogëlimit të çmimeve të mallrave të importuara, gjë që reflekton lidhshmërinë e fortë të zhvillimeve në nivelin e çmimeve në Kosovë me ato në tregjet ndërkombëtare. Norma mesatare e inflacionit gjatë vitit 2014 ishte 0.4 përqind, që paraqet nivelin më të ulët të inflacionit në vitet e fundit. Në rënie të inflacionit kontributin kryesor e kishin çmimet e veshmbathjes, shërbimet e transportit, mjetet e komunikimit dhe shërbimet arsimore, ndërsa çmimet e energjisë, pijeve alkoolike dhe duhanit kanë kontribuar pozitivisht në shkallën e inflacionit.

Zhvillimet sektoriale gjatë vitit 2014 tregojnë për një rënie të prodhimit të energjisë në termocentrale prej rreth 15 përqind krahasuar me vitin paraprak. Rënia e prodhimit të energjisë në vitin 2014 mund t'i atribuohet deri në një masë shpërthimit që ndodhi në qershor të vitit 2014 në termocentralin Kosova A. Të dhënat e indeksit për qarkullimin industrial tregojnë për rritje të qarkullimit në sektorin e industrisë përpunuese, përderisa indeksi i qarkullimit për industrinë nxjerrëse, furnizimi me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar dhe furnizim me ujë, veprimtari të menaxhimit dhe trajtim të mbeturinave ka shënuar rënie.

Sektori fiskal u karakterizua me rritje të lehtë të të hyrave dhe nivel të ngjashëm të shpenzimeve të realizuara krahasuar me vitin paraprak. Të hyrat e përgjithshme buxhetore shënuan rritje prej 1.5 përqind dhe arritën vlerën prej 1.3 miliardë euro në vitin 2014. Në anën tjetër, vlera e përgjithshme e shpenzimeve buxhetore arriti në rreth 1.5 miliard euro, nivel pothuajse i njëjtë me vitin paraprak. Në vitin 2014, Buxheti i Kosovës regjistroi deficit primar prej 131 milionë euro krahasuar me 150 milionë euro deficit të shënuar në vitin paraprak. Borxhi i përgjithshëm i qeverisë në dhjetor 2014 ishte 582.9 milionë euro apo 10.6 përqind e PBB-së krahasuar me 476.3 milionë euro apo 9.1 përqind e PBB-së në vitin 2013. Kosova vazhdon të ketë nivelin më të ulët të borxhit publik krahasuar me vendet e rajonit (57.3 përqind e PBB-së ishte mesatarja e borxhit publik për vendet e rajonit në vitin 2014). Përveç se ka nivelin më të ulët të borxhit publik, Kosova gjatë vitit 2014 ka shënuar edhe normë më të ulët të rritjes së vlerës së borxhit publik krahasuar me mesataren e rritjes së borxhit publik në vendet tjera të rajonit.

Sistemi financiar i Kosovës gjatë vitit 2014 është karakterizuar me zgjerim të aktivitetit dhe nivel të lartë të qëndrueshmërisë në të gjithë sektorët përbërës të tij. Aktiviteti kreditues i sektorit bankar është rimëkëmbur pas ngadalësimit të rritjes që shënoi në dy vitet paraprake, duke përforcuar kështu rolin e sektorit bankar në financimin e aktivitetit ekonomik në vend. Vlera e gjithsej kredive deri në dhjetor 2014 arriti në 1.88 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 4.2 përqind. Ndikim të rëndësishëm në përshpejtimin e rritjes së aktivitetit kreditues ka pasur lehtësimi i standardeve kreditore dhe përmirësimi i kushteve të kreditimit nga ana e bankave, përderisa edhe kërkesa për kredi ka shënuar rritje. Struktura e kreditimit të ndërmarrjeve mbetet e ngjashme me vitet paraprake, ku kreditë e destinuar për sektorin e tregtisë paraqesin kategorinë më të madhe me pjesëmarrje prej 53.4 përqind në gjithsej kreditë për ndërmarrjet. Rritja e aktivitetit kreditues në vend është financuar kryesisht nga rritja e depozitave të mbledhura brenda vendit. Depozitat në sektorin bankar të Kosovës shënuan rritje vjetore prej 3.6 përqind, duke arritur në 2.53 miliardë euro në dhjetor 2014. Gjatë vitit 2014, struktura e depozitave sipas afatit të maturimit ka pësuar ndryshime, ku vërehet një zvogëlim i theksuar i peshës së depozitave të afatizuara, të cilat në vitet kaluara përfaqësonin pjesën më të madhe të gjithsej depozitave, përderisa vërehet rritje e depozitave të transferueshme dhe të kursimit. Ky zhvillim në strukturën e depozitave sipas afatit të maturimit kryesisht është pasojë e rënies së theksuar e normës së interesit në depozita, gjë që mund të ketë dekurajuar afatizimin e depozitave nga depozitorët.

Në vitin 2014, bilanci i pagesave në Kosovë u karakterizua me rritje të deficitit në llogarinë rrjedhëse dhe kapitale, përderisa llogaria financiare mbeti në nivel përafërsisht të ngjashëm me vitin paraprak. Raporti i deficitit të llogarisë rrjedhëse ndaj PBB-së në vitin 2014 shënoi rritje në 7.6 përqind të PBB-së, nga 5.7 përqind të PBB-së sa ishte në vitin 2013. Vëllimi i shkëmbimeve tregtare të mallrave dhe shërbimeve gjatë vitit 2014 shënoi rritje prej 10.6 përqind dhe, rrjedhishimisht, shkalla e hapjes tregtare arriti në rreth 71 përqind të PBB-së (66 përqind në vitin 2013). Në vitin 2014, deficitit tregtar në mallra dhe shërbime arriti vlerën prej 1.7 miliard euro (rreth 31 përqind e PBB-së), që paraqet një rritje vjetore prej 2.3 përqind. Vlera e gjithsej mallrave të eksportuara nga Kosova në vitin 2014 arriti në 324.5 milion euro, që përkon me një rritje vjetore prej 10.4 përqind. Rritja e vlerës së mallrave të eksportuara në vitin 2014 kryesisht reflekton rritjen e çmimit të një ndër metaleve kryesore që eksporton Kosova (nikelit), si dhe rritjen e aktivitetit në disa sektorë të ekonomisë gjatë kësaj periudhe. Ndërsa, mallrat e importuara në vend u karakterizuan me një rritje vjetore prej 3.6 përqind, duke arritur vlerën prej 2.5 miliard euro. Rritja që i karakterizoi importet në vitin 2014 i atribuohet kryesisht rritjes së kërkesës së brendshme, përderisa rënia e çmimeve në produktet kryesore që importohen në Kosovë (veçanërisht çmimet e naftës dhe ushqimit) kontribuan negativisht në rritjen e vlerës së importeve edhe në vitin 2014.

Vlera e gjithsej remitencave të pranuar në Kosovë arriti në 693.7 milionë euro në vitin 2014, që paraqet një rritje vjetore prej 11.7 përqind, duke vazhduar kështu të përfaqësojnë një burim të qëndrueshëm të financimit të konsumit në Kosovë. Në kuadër të llogarisë financiare, bilanci i investimeve direkte u zvogëlua për rreth 51 përqind në vitin 2014, duke shënuar vlerën prej 123.8 milionë euro. Investimeve të Huaja Direkte (IHD) në Kosovë në vitin 2014 shënuan vlerën prej 151.2 milionë euro krahasuar me vlerën prej 280.2 milion euro në vitin 2013.

Për vitin 2015, projeksionet e BQK-së sugjerojnë se ekonomia e Kosovës do të karakterizohet me përsheptim të rritjes ekonomike, duke shënuar një normë reale të rritjes së PBB-së prej 3.5 përqind, e cila pritet të gjenerohet kryesisht nga kërkesa e brendshme. Konsumi, si komponenta kryesore e kërkesës së brendshme, pritet që edhe gjatë vitit 2015 të ketë kontributin kryesor në rritjen ekonomike, por me një shkallë më të vogël të kontributit krahasuar me vitin paraprak. Në anën tjetër, investimet të cilat në vitin e kaluar vlerësohet të kenë shënuar rënie, gjatë këtij viti pritet të shënojnë rritje. Trendet e deritanishme të vitit 2015 sugjerojnë për rritje të burimeve të financimit të konsumit por edhe të investimeve. Rritja e kërkesës së brendshme pritet të ndikojë në rritje të importit dhe, rrjedhimisht, në rritje të deficitit të llogarisë rrjedhëse. Ndërsa, llogaria financiare e bilancit të pagesave pritet të përmirësohet, kryesisht për shkak të parashikimeve për rritje të investimeve të huaja direkte. Sektori fiskal pritet të karakterizohet me rritje të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore, por rritja e shpenzimeve pritet të jetë më e lartë duke bërë kështu që edhe deficitin primar të rritet në krahasim me vitin paraprak. Për sa i përket sektorit financiar, aktiviteti kredihënës pritet të vazhdojë trendin e rritjes, duke shërbyer kështu si burim i rëndësishëm i financimit të rritjes ekonomike në vitin 2015.

2. Ekonomia e Eurozonës dhe e Ballkanit Perëndimor

Aktiviteti ekonomik në eurozonë gjatë vitit 2014 është rikuperuar gradualisht. Gjatë vitit 2014, pozicioni i investimeve dhe neto eksportet kishin ndikim të vogël në rikuperimin e aktivitetit ekonomik në eurozonë, përderisa rritja modeste ekonomike u mbështet kryesisht në rritjen e kërkesës së brendshme si rezultat i përmirësimit të besueshmërisë së konsumatorëve dhe përmirësimit gradual të kushteve në tregun e punës. Rritja e aktivitetit ekonomik mbeti e koncentruar në ekonomitë qendrore të eurozonës, gjegjësisht në Gjermani, Francë, Spanjë përderisa pjesë të ndryshme të eurozonës vazhduan të karakterizohen me rritje të dobët, përkatësisht rënie ekonomike. Në vitin 2014, ekonomia e eurozonës shënoi rritje vjetore prej 0.8 përqind, kundrejt rënies prej 0.4 përqind të shënuar në vitin paraprak. Në gjysmën e parë të vitit 2015, rikuperimi ekonomik në eurozonë vlerësohet të jetë zgjeruar kundrejt periudhës së njëjtë të vitit paraprak, duke u mbështetur në përforcimin e kërkesës së brendshme si rezultat i rritjes së konsumit privat, rritjes së investimeve dhe përmirësimit të pozicionit të neto eksporteve. Në linjë me pritjet, niveli i çmimeve të naftës gjatë vitit 2015 mbeti i ulët, duke mbështetur rritjen e mëtejme të konsumit privat dhe investimeve përmes rritjes së të ardhurave të disponueshme për ekonomitë familjare dhe rritjes së profitabilitetit të korporatave. Për vitin 2015, FMN parashikon një rritje ekonomike prej 1.5 përqind në eurozonë.


Sipas BQE-së, shkalla mesatare e inflacionit në eurozonë në vitin 2014 zbriti në 0.4 përqind, nën objektivin prej 2 përqind të BQE-së, nga 1.4 përqind sa ishte në vitin 2013. Tremujori i parë i vitit 2015 u karakterizua me deflacion në eurozonë (rreth -0.3 përqind), kryesisht si pasojë e rënies së çmimeve në tregjet ndërkombëtare, përderisa në tremujorin e dytë të vitit eurozona u karakterizua me një normë mesatare të inflacionit prej 0.2 përqind.

Për të ju kundërvënë rrezikut të ngritjes së deflacionit në eurozonë dhe për të rimëkëmbur ekonominë ende të brishtë në rajon, BQE vendosi të lansojë programin e lehtësimit sasior në muajin mars të vitit 2015. Duke blerë letra me vlerë të qeverive evropiane dhe agjencive e institucioneve evropiane në tregjet dytësore në baza mujore në vlerë prej 60 miliard euro, programi i lehtësimit sasior synonte ndikimin direkt përmirësimin e kushteve të financimit dhe nxitjen e investimeve në eurozonë. Programi i lehtësimit sasior në shkallë të gjerë pritet të zgjasë deri në shtator të vitit 2016.

Në vitin 2014, BQE zvogëloi në mënyrë të vazhdueshme normën bazë të refinancimit, gjë që ndikoi në një rënie të normave 1 mujore dhe 12 mujore të interesit të kreditimit ndërbankar Euribor. Në vitin 2014, norma mesatare 1 mujore e Euribor është zvogëluar në 0.12 përqind nga 0.13 përqind në vitin 2013 (figura 1). Gjithashtu, norma mesatare Euribor për periudhën 12 mujore ka shënuar rënie në 0.48 përqind në vitin 2014, nga 0.54 përqind në vitin 2013.

Rritja graduale e kërkesës së brendshme dhe politika e lehtësuar monetare janë reflektuar edhe në rritjen e aktivitetit kreditues në eurozonë. Gjatë vitit 2014, pas më shumë se dy vitesh, kreditimi i sektorit privat ka shënuar një rritje modeste. Kreditimi i sektorit privat shënoi një rritje prej 0.2 përqind në vitin 2014, kundrejt rënies vjetore të shënuar në dy vitet paraprake prej

Figura 1. Norma e kreditimit ndërbankar EURIBOR dhe norma e refinancimit e ECB-së



Burimi: Euribor (2014) dhe ECB (2014)

2.0 përkatësisht 0.1 përqind. Rritja e kreditimit të sektorit privat, sipas anketës për kreditim bankar të BQE-së, i atribuohet kryesisht rritjes së kërkesës për financim të investimeve fikse të ndërmarrjeve si dhe lehtësimit të standardeve kreditore nga bankat.

Performanca e aktivitetit ekonomik në Ballkanin Perëndimor gjatë vitit 2014 përgjithësisht vlerësohet të ketë qenë më e dobët krahasuar me vitin 2013. Ngadalësimi i rritjes ekonomike në vitin 2014 në Ballkanin Perëndimor iu atribuua rritjes së dobët të konsumit dhe përkeqësimit të pozicionit të neto eksporteve si pasojë e rikuperimit të dobët të kërkesës në eurozonë. Rritja mesatare ekonomike në vendet e Ballkanit Perëndimor në vitin 2014 vlerësohet të ketë qenë 1.5 përqind (2.6 përqind në vitin 2013). Rritjen më të lartë ekonomike në rajon e shënoi Maqedonia (3.8 përqind), përderisa Serbia ishte vendi i vetëm në rajon që u karakterizua me rënie ekonomike në vitin 2014. Për vitin 2015, FMN parashikon përsheptim të rritjes ekonomike në vendet e Ballkanit Perëndimorë ku norma e rritjes pritet të arrijë në 2.8 përqind. Mali i Zi pritet të shënoj rritjen më të lartë ekonomike në vitin 2015 (4.7 përqind), pasuar nga Maqedonia dhe Kosova (3.8 përkatësisht 3.3 përqind), përderisa Serbia pritet të ketë rënie ekonomike prej 0.5 përqind.

Ngjashëm me vendet e eurozonës, vendet e Ballkanit Perëndimor janë karakterizuar me shkallë më të ulët të inflacionit, përkatësisht deflacionit në vitin 2014 kundrejt vitit paraprak, që i atribuohet kryesisht çmimeve të ulëta të energjisë dhe ushqimit në tregjet ndërkombëtare. Norma mesatare e inflacionit në vendet e rajonit në vitin 2014, sipas FMN-së, ishte 0.4 përqind. Serbia, Shqipëria dhe Kosova u karakterizuan me një shkallë të inflacionit prej 2.1, 1.6 përkatësisht 0.4 përqind, përderisa Mali i Zi, Bosnja e Hercegovina dhe Maqedonia u karakterizuan me deflacion.

Gjendja në tregun e punës në vendet e Ballkanit Perëndimor vlerësohet të jetë përmirësuar në vitin 2014 kundrejt vitit paraprak. Vlerësimet e fundit tregojnë për një shkallë mesatare të papunësisë në EJJL prej 26 përqind, që është për 0.5 pikë përqindje më e ulët krahasuar me vitin e kaluar. Shkalla më e lartë e papunësisë vazhdon të jetë në Bosnje e Hercegovinë (43.6 përqind), Kosovë (30 përqind), Maqedoni (28 përqind), dhe Serbi (18.9 përqind), ndërsa shkallën më të ulët të papunësisë vazhdojnë ta kenë Mali i Zi dhe Shqipëria (rreth 18 përqind). Në kuadër të zhvillimeve në sektorin e jashtëm, vendet e Ballkanit Perëndimor u karakterizuan me përkeqësim të deficitit të llogarisë rrjedhëse në vitin 2014. Norma mesatare e deficitit të llogarisë rrjedhëse në vendet e rajonit në vitin 2014 ishte 8.5 përqind e PBB-së, që është për 0.9 pikë përqindje më e lartë krahasuar me vitin paraprak. Mali i Zi raportoi normën më të lartë të deficitit të llogarisë rrjedhëse (15.3 përqind e PBB-së), ndërsa Maqedonia normën më të ulët të deficitit (1.3 përqind e PBB-së). Përveç Maqedonisë dhe Serbisë që u karakterizuan me zvogëlim të shkallës së deficitit të llogarisë rrjedhëse krahasuar me vitin 2013, në vendet tjera deficioni i llogarisë rrjedhëse u karakterizua me rritje. Ky përkeqësim i deficitit të llogarisë rrjedhëse ishte kryesisht rezultat i rënies, gjegjësisht rritjes më të ngadalshme të eksporteve në Ballkanin Perëndimor gjatë vitit 2014, përderisa importet u karakterizuan me rritje. Ndërkohë, bilanci i Investimeve të Huaja Direkte (IHD), i cili paraqet një komponentë shumë të rëndësishme për financimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse, është përkeqësuar në vitin 2014. Me përkeqësim të bilancit të IHD-ve në raport me PBB-në në vitin 2014 kundrejt vitit paraprak u karakterizuan Shqipëria, Maqedonia, Kosova dhe Serbia, përderisa rritje të bilancit të IHD-ve në të njëjtën periudhë raportuan Mali i Zi dhe Bosnja dhe Hercegovina.

Si rezultat i masave të kursimit të ndërmarra nga disa nga qeveritë e vendeve të rajonit, është shënuar përmirësim në bilancet e tyre buxhetore. Deficioni buxhetor është zvogëluar nga mesatarisht 4.2 përqind e PBB-së sa ishte në vitin 2013, në mesatarisht 3 përqind në vitin 2014. Shkallën më të lartë të deficitit buxhetor e shënoi Serbia (6.7 përqind të PBB-së), pasuar nga Shqipëria dhe Maqedonia (5.1 përkatësisht 4.2 përqind të PBB-së). Në të njëjtën periudhë, Mali i

Zi u karakterizua me shkallën më të ulët të deficitit (1.5 përqind të PBB-së), përderisa Bosnja dhe Hercegovina raportoi suficit buxhetor (1.0 përqind të PBB-së). Në vitin 2014 kundrejt vitit paraprak, të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor u karakterizuan me rritje të shkallës së borxhi publik. Shkalla mesatare e borxhit publik në vendet e Ballkanit Perëndimor në vitin 2014 ishte mesatarisht 49 përqind e PBB-së (rreth 45 përqind të PBB-së në vitin 2013). Shqipëria dhe Serbia, përveç se kanë nivelin më të lartë të borxhit publik (rreth 71 përqind e PBB-së), janë vendet të cilat në vitin 2014 e thelluan më së shumti borxhin publik krahasuar me vitin paraprak. Kosova vazhdon të ketë shkallën më të ulët të borxhit publik në rajon me vetëm rreth 10.6 përqind të PBB-së.

Vendet në Ballkanin Perëndimor u karakterizuan me rritje të aktivitetit kreditor në vitin 2014. Me përjashtim të Malit të Zi që shënoi rënie të kreditimit, të gjitha vendet e tjera u karakterizuan me përshpejtim të rritjes së kredive. Megjithatë, rritja e kreditimit në vendet e Ballkanit Perëndimor u mbështet kryesisht në rritjen e kreditimit për ekonomitë familjare, përderisa kreditimi i ndërmarrjeve është vlerësuar të ketë stagnuar. Sa i përket depozitave në bankat komerciale në vendet e Ballkanit Perëndimor, Shqipëria dhe Kosova u karakterizuan me ngadalësim të rritjes së gjithsej depozitave në vitin 2014, përderisa të gjitha vendet tjera kishin përshpejtim të rritjes së depozitave. Vendet në Ballkanin Perëndimor raportuan kryesisht rënie të kredive jo-performuese gjatë vitit 2014, me përjashtim të Bosnje dhe Hercegovinës dhe Maqedonisë që raportuan përkeqësim të kualitetit të portofolios kreditorë.

Programi i lehtësimit sasior nga BQE dhe politika e lehtësuar monetare janë përkthyer në dobësimin e monedhës së euros kundrejt valutave kryesore gjatë vitit 2014. Norma mesatare e këmbimit të euros ndaj dollarit amerikan në vitin 2014 ishte pothuajse në nivel të njëjtë me vitin paraprak (0.1 përqind rritje), megjithëse në katër muajt e fundit të vitit 2014 euro u karakterizua me rënie të madhe kundrejt dollarit amerikan (10 përqind rënie vjetore në dhjetor 2014). Ndaj sterlinës britanike dhe ndaj frankës zvicerane, euro ka shënuar rënie mesatare vjetore prej 5.0 përkatësisht 1.3 përqind. Sa i përket valutave të vendeve të rajonit, në vitin 2014 euro është vlerësuar kundrejt dinarit serb, kunës kroate dhe denarit maqedon për mesatarisht 3.7, 0.7 përkatësisht 0.1 përqind, përderisa është zhvlerësuar kundrejt lekut shqiptar për 0.2 përqind.

3. Çmimet e mallrave kryesore në tregjet ndërkombëtare


3.1. Çmimet e naftës

Çmimet e naftës (brent crude)¹ gjatë vitit 2014 shënuan rënie mesatarisht për 9.1 përqind krahasuar me vitin 2013. Siç edhe shihet në figurën 2 rënia e çmimit të naftës ka filluar në gjysmën e dytë të vitit 2014 pas disa viteve që ishte karakterizuar me një stabilitet të çmimit. Vetëm në dhjetor 2014 një barel ka kushtuar 62.3 dollar apo 43.7 përqind më lirë se sa në dhjetor 2013. Rënia e çmimit ka vazhduar edhe në janar 2015 dhe ka rritur në 48.1 dollar për barel apo 55.3 përqind më lirë se sa në janar 2014, ndërkohë që është vërejtur një ngritje e lehtë e çmimit në muajin shkurt. Projeksionet e EIA (US Energy Information Administration) për vitin 2015 sugjerojnë se çmimet e naftës pritet të mbesin relativisht stabile. Kjo pasi që pritet se nuk do të ketë goditje nga ana e ofertës si rezultat i prodhimit të lartë në SHBA, përderisa vendet e Lindjes së Mesme vlerësohet se do të kenë nevojë të mbajnë nivele të larta të eksportit të naftës.

Faktor kryesor që ka ndikuar në rënien e çmimeve të naftës gjatë vitit 2014 konsiderohet të ketë qenë rritja e prodhimit të naftës në SHBA duke e bërë SHBA-në ndër prodhuesit kryesor në nivel global. Edhe pse SHBA nuk eksporton naftë të papërpunuar, si rezultat i rritjes së prodhimit të brendshëm, ajo ka zvogëluar importin e naftës. Rënia e importit të naftës nga SHBA-të ka ndikuar që kërkesa për naftë në tregjet ndërkombëtare të zvogëlohet, duke shkaktuar kështu edhe rënie të çmimit. Përveç kësaj, organizata OPEC (angl. Organization of Petroleum Exporting Countries) nuk ka arritur konsensus të brendshëm për zvogëlimin e prodhimit të naftës. Ata nuk kanë dashur të sakrifikojnë pjesën e tyre të tregut në përpjekje për të rivendosur çmimin në nivele më të larta, gjë që ka mundësuar vazhdimin e rënies së çmimit të këtij produkti. Për më tepër, Arabia Saudite, si prodhuesi më i madh i OPEC-ut, mund të toleroj çmime të ulëta të naftës për shkak të rezerva të mëdha që ka dhe kostos mjaft të ulët për ta nxjerr naftën nga toka. Rënies së çmimit të naftës i ka kontribuar edhe aktiviteti ekonomik në nivel global i cili u rikuperua me një ritëm më të ngadalshëm gjatë vitit 2014.

Rënia e çmimeve të naftës, për vendet importuese, mund të ketë ndikuar në nxitjen e aktivitetit ekonomik si dhe në zvogëlimin e presioneve inflacioniste, sidomos tek produktet ushqimore, pasi që nafta dhe energjia përbëjnë komponentë mjaft të rëndësishëm në procesin e prodhimit dhe transportimit të tyre. Zvogëlimi i çmimeve të naftës gjatë vitit 2014 vlerësohet të ketë ndikuar pozitivisht edhe në përmirësimin e bilancit të llogarisë rrjedhëse të vendeve importuese të naftës, pasi që për të njëjtën sasi të importuar vlera nominale e pagesave është më e ulët. Këto elemente pozitive nga rënia e çmimeve të naftës e kanë karakterizuar edhe ekonominë e Kosovës, ku është shënuar rënie e çmimeve të ushqimit, si dhe vlera nominale e pagesave për importin e naftës ka qenë më e ulët në vitin 2014 krahasuar me vitin 2013.

Figura 2. Çmimi i naftës "brent crude" për barel



Burimi: Banka Botrore (2015)


¹ 'Brent Crude' paraqet klasifikim tregtar për naftën e prodhuar në detin e veriut si përfaqësues i nivelit të çmimit të naftës në nivel global.

3.2. Çmimet e arit

Gjatë vitit 2014 rënie ka shënuar edhe çmimi i arit, i cili është zvogëluar për mesatarisht 10.3 përqind (figura 3). Në dhjetor një unce ari (31.1 gram ari) ka kushtuar 1,200.6 dollarë që është 1.7 përqind më lirë se sa në dhjetor 2013. Në janar 2015 është vërejtur një ngritje e çmimit të arit ku çmimi për unce ka arritur në 1,250.7 dollar apo 0.5 përqind më shtrenjtë se sa në janar të vitit 2014.

Çmimet e arit zakonisht ngritën në periudha kur ka nivel të lartë të inflacionit ose kur ekonomitë e mëdha ballafaqohen me krizë. Inflacioni gjatë vitit 2014 nuk ka qenë shqetësim, mirëpo shumë nga ekonomitë e mëdha janë ballafaquar me vështirësi. Sidoqoftë, këto vështirësi nuk kanë arritur të ndikojnë në rritje të çmimit të arit. Si arsye kryesore për mos rritjen e çmimit të arit në kushtet e performancës jo të mirë ekonomike në vendet e zhvilluara konsiderohet të ketë qenë zvogëlimi i normës bazë të refinancimit të BQE-së e cila ka ndikuar që dollari të forcohet ndaj euros. Forcimi i dollarit zakonisht përkthehet në kërkesë më të vogël për ari, gjë që ka parandaluar rritjen e çmimit të arit. Edhe gjatë vitit 2015, çmimet e arit pritet të jenë kryesisht stabile.

Figura 3. Çmimi i arit, në USD për unce




Burimi: Banka Botrore (2015)

3.3. Çmimet e metaleve dhe mineraleve

Rënia e çmimeve të produkteve kryesore është reflektuar edhe në çmimet e metaleve dhe mineraleve që gjatë viteve të fundit u karakterizuan me ndryshime të vogla dhe tendencë rënëse. Gjatë vitit 2014, indeksi i çmimit të metaleve dhe mineraleve ka shënuar rënie prej 6.6 përqind (figura 4). Rënia më e madhe e indeksit u shënuar në dhjetor 2014 prej 11.2 përqind, ndërkohë që rënia ka vazhduar edhe në vitin 2015, ku në janar ky indeks ka shënuar rënie prej 16.2 përqind. Në kuadër të indeksit të çmimeve të metaleve dhe mineraleve, rënie më të theksuar gjatë vitit 2014 e kanë shënuar mineralet e hekurit prej 28.4 përqind, pasuar nga bakri dhe plumbi me 6.4 përkatësisht 2.1 përqind. Në anën tjetër, çmimet e zinkut dhe nikelit u karakterizuan me rritje të konsiderueshme prej 13.1 përkatësisht 12.4 përqind. Edhe çmimet e aluminit u karakterizuan me ngritje të lehtë prej 1.1 përqind. Lëvizjet në çmimet e metaleve reflektohen edhe në ekonominë e Kosovës pasi që metalet bazë kanë një pjesëmarrje të lartë në gjithsej eksportin e Kosovës.

Figura 4. Indeksi i çmimeve të metaleve dhe mineraleve




Burimi: Banka Botrore (2015)

3.4. Çmimet e prodhimeve ushqimore

Çmimet e ushqimit kanë vazhduar trendin e rënies, trend ky i cili filloi që nga qershori 2013. Indeksi i çmimeve të ushqimit gjatë vitit 2014 krahasuar me vitin paraprak ka shënuar rënie për 3.8 përqind (figura 5). Indeksi i çmimeve të drithërave ka shënuar rënie prej 12.5 përqind, e cila pjesërisht mund të shpjegohet me rënien prej 9.1 përqind të çmimeve të naftës por edhe për shkak të ofertës mjaftë të lartë në nivel global. Si rezultat i ofertës stabile, çmimet e produkteve ushqimore parashikohet se do të vazhdojnë trendin e rënies edhe në vitin 2015. Sipas parashikimeve të FMN-së indeksi i çmimeve të ushqimit do të shënoj rënie për 11.3 përqind ndërsa indeksi i çmimeve të drithërave do të shënoj rënie për 20.7 përqind.

Figura 5. Indeksi i çmimeve të ushqimit dhe indeksi i çmimeve të drithrave



Burimi: FAO (2015)

4. Ekonomia e Kosovës


4.1. Produkti i brendshëm bruto

Ekonomia e Kosovës gjatë vitit 2014 u karakterizua me aktivitet më të ngadalësuar ekonomik. Sipas vlerësimeve preliminare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), norma reale e rritjes së PBB-së në Kosovë ishte 0.9 përqind, që është dukshëm më e ulët se sa në vitet e kaluara (figura 6). Ky vlerësim bazohet në rritjen e investimeve prej 1.5 përqind dhe konsumit prej vetëm 1.4 përqind, ndërkohë që neto eksportet e thelluan deficitin tregtar për 3.2 përqind. Sipas vlerësimeve të ASK-së, vlera nominale e PBB-së në vitin 2014 arriti në 5.5 miliard euro (figura 7). Ky megjithatë është vetëm një vlerësim preliminar, ndërsa vlerësimi zyrtar i PBB-së për vitin 2014 pritet të bëhet nga ASK-ja në nëntor të vitit 2015.

Normë pozitive të rritjes ekonomike për vitin 2014 dhe më të ulët krahasuar me rritjen e vitit të kaluar sugjerojnë edhe vlerësimet e BQK-së. Mirëpo, për dallim nga vlerësimet e ASK-së, vlerësimet e BQK-së sugjerojnë se aktiviteti ekonomik në vitin 2014 ka shënuar normë më të lartë të rritjes. Rritja ekonomike në vitin 2014, sipas vlerësimeve të BQK-së, është mbështetur kryesisht në rritjen e konsumit, përderisa investimet dhe neto eksportet vlerësohet të kenë kontribuar negativisht. Dallimi kryesor sa i përket vlerësimeve të ASK-së dhe atyre të BQK-së qëndron tek komponenta e konsumit. Për dallim nga ASK-ja, e cila ka vlerësuar se konsumi ka shënuar rritje prej vetëm 1.4 përqind, BQK-ja vlerëson se konsumi ka shënuar rritje prej 6.1 përqind.


Vlerësimi i BQK-së për rritjen e përsheptuar të konsumit bazohet kryesisht në rritjen e konsumit privat prej rreth 5.9 përqind, që njëherësh ka edhe pjesëmarrjen më të lartë në gjithsej konsumin (84.3 përqind). Rritja e kredive të reja konsumuese (48.7 përqind) dhe remitencave (11.8 përqind) kanë ndikuar në rritjen e të ardhurave të disponueshme të qytetarëve dhe, rrjedhimisht, në rritjen e konsumit privat. Edhe të dhënat rreth qarkullimit të ndërmarrjeve paraqesin rritje të qarkullimit me mbi 3 përqind, indikator ky i rëndësishëm për të pasqyruar rritjen e konsumit. Përveç kësaj, edhe të dhënat e importit të mallrave konsumuese, të cilat shënuan rritje të konsiderueshme (12.1 përqind), sugjerojnë për rritje të konsumit. Po ashtu, si rezultat i vendimit të qeverisë për rritjen e pagave dhe pensione, konsumi publik ka shënuar rritje të konsiderueshme (7.1 përqind). Duke pasur parasysh faktorët e lartcekur, konsiderojmë se vlerësimi zyrtar i PBB-së për vitin 2014, i cili pritet të publikohet nga ASK-ja në nëntor të vitit 2015, do të paraqesë një normë më të lartë të rritjes së konsumit dhe të PBB-së për vitin 2014.

Figura 6. Rritja reale e PBB-së



* Vlerësim i ASK-së
Burimi: ASK (2015)

Figura 7. Komponentat kryesore të PBB-së, vlera nominale, në miliardë euro



Burimi: ASK (2015)

Rënia e çmimit të shërbimeve arsimore i atribuohet vendimit të qeverisë për zbritjen e pagesës për 50 përqind për studentët e universiteteve publike ndërsa rënia e çmimeve të shërbimeve të transportit i atribuohet rënies së çmimit të derivateve të naftës. Përveç çmimeve të arsimit dhe transportit, me rënie u karakterizuan edhe çmimet e mjeteve të komunikimit si dhe çmimet e ushqimit dhe pijeve joalkoolike të cilat shënuan rënie për 1.0 përkatësisht 0.2 përqind. Në vitin 2014, rritje të çmimeve shënuan pijet alkoolike dhe duhani për 4.3 përqind, rryma, gazi dhe lëndët tjera djegëse për 4.1 përqind, restorantet dhe hotelet për 1.1 përqind, etj.

Kategoria e pijeve alkoolike dhe duhanit shënoi rritje të çmimeve për 4.3 përqind. Në kuadër të kësaj kategorie, çmimet e duhanit shënuan rritje për 5.6 përqind, ndërsa çmimet e alkoolit shënuan rënie për 0.9 përqind. Rritja e çmimeve të duhanit është kryesisht rezultat i vendimit të qeverisë për rritje të akcizës së duhanit nga 30 në 32 euro për njësi duke filluar nga janari 2014. Siç edhe është paraqitur në figurën 9, lëvizjet në çmimet e duhanit në Kosovë përcaktohen në masë të konsiderueshme nga akciza e aplikuar për këtë produkt. Në anën tjetër, kategoria e ushqimit dhe pijeve joalkoolike shënoi rënie për 0.2 përqind, përderisa në vitin paraprak kishin shënuar rritje për 2.1 përqind. Në kuadër të kategorisë së ushqimit, rënia më e theksuar e çmimeve është shënuar te vajrat dhe yndyrërat me 9.3 përqind, si dhe buka dhe drithërat me 2.2 përqind, ndërsa për shkak të kushteve jo të favorshme klimatike, çmimet e pemëve shënuan rritje për 3.5 përqind (figura 10).

Çmimet e strehimit, ujit, rrymës dhe lëndëve tjera djegëse në vitin 2014 shënuan rritje mesatare prej 4.1 përqind (0.4 përqind rritje në vitin paraprak). Kjo rritje më e lartë e çmimeve të kësaj kategorie ishte për shkak të rritjes së çmimeve të strehimit prej 7.1 përqind si dhe rritjes së çmimit të rrymës dhe lëndëve tjera djegëse prej 5.6 përqind. Rritje të çmimeve prej 0.4 përqind shënoi edhe furnizimi me ujë dhe shërbimet e ndryshme që kanë të bëjnë me vendbanimin (figura 11).

Figura 9. Indeksi i çmimeve të duhanit dhe akciza në duhan në euro




Figura 10. Çmimet e ushqimit dhe kategoritë kryesore të tijë, rritja vjetore në përqindje





Figura 11. Çmimet e strehimit, ujit dhe energjisë, rritja vjetore në përqindje



Lëvizja e çmimeve të nënkategorisë së rrymës, gazit dhe lëndëve tjera djegëse është në masë të konsiderueshme e përcaktuar nga lëvizja e çmimit të energjisë që kanë peshën më të madhe në kuadër të kësaj nënkategorie. Siç edhe është paraqitur në figurën 12, indeksi i çmimit të energjisë, i cili karakterizohet me ndryshime të theksuara sezonale (varësisht nga tarifa verore dhe dimërore), është karakterizuar me trend rritës.


Mesatarja vjetore e çmimeve të shërbimeve në vitin 2014 shënoi rënie për 1.5 përqind krahasuar me rritjen prej 0.4 përqind në vitin paraprak. Megjithatë, përbrenda kategorisë së shërbimeve kishte lëvizje të ndryshme të çmimeve. Rënien më të madhe të çmimeve e shënuan shërbimet arsimore për 7.0 përqind, pasuar nga çmimet e shërbimeve të transportit dhe të komunikimit të cilat shënuan rënie për 2.1 përkatesisht 1.0 përqind. Në anën tjetër, rritje e çmimeve është shënuar te shërbimet e hotelerisë për 1.1 përqind si dhe shërbimet shëndetësore për 0.2 përqind (figura 13).

Sa i përket normës reale efektive të këmbimit (NREK) të euros në Kosovë kundrejt valutave të partnerëve tregtarë, e cila bazohet në çmimet e konsumit, gjatë vitit 2014 ajo u vlerësua për mesatarisht 0.2 përqind. NREK u vlerësua për 0.3 përqind ndaj vendeve të CEFTA-s, ndërsa ndaj vendeve të BE-së mbeti pothuajse e pandryshuar, gjë që nënkupton se produktet kosovare mund të kenë zvogëluar konkurrueshmërinë ndaj vendeve të CEFTA-së ndërsa ndaj vendeve të BE-së konkurrueshmëria e produkteve kosovare ka mbetur e njëjtë.

4.2.1. Inflacioni bazë


Shporta e konsumatorit kosovar karakterizohet me pjesëmarrje mjaft të lartë të produkteve të cilat kanë lëvizje sezonale të çmimeve. Këtu përfshihen ushqimi, energjia, pijet alkoolike dhe duhani të cilat përbëjnë rreth gjysmën e shportës së konsumatorit. Çmimet e këtyre produkteve kanë determinuar lëvizjen e çmimeve gjatë viteve të kaluara jo vetëm për shkak të pjesëmarrjes së lartë që e kanë në shportën e konsumatorit por edhe për shkak se lëvizja e këtyre çmimeve ka qenë më e theksuar (tabela 1). Kjo bënë që ndikimi i këtyre kategorive në gjithsej lëvizjen e çmimeve të jetë më i lartë se sa në vendet tjera të cilat kanë pjesëmarrje më të ulët të këtyre kategorive në shportën e konsumatorit. Sidoqoftë, në vitet e fundit vërehet një stabilitet i çmimeve të këtyre produkteve por edhe tendencë rënëse në nivelin e pjesëmarrjes në gjithsej shportën e konsumatorit.

Figura 12. Indeksi i çmimit të energjisë dhe çmimi për KWh



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së (2014)

Figura 13. Çmimet e shërbimeve, rritja vjetore në përqindje



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së (2015)


Tabela 1. Struktura e IÇK-së

Përshkrimi	Peshat 2014	Mesatarja vjetore e rritjes, %							
		2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	
IÇK	100.0%	9.1	-2.3	3.5	7.3	2.5	1.8	0.4	
<i>Struktura e IÇK-së:</i>									
Ushqimi	38.2%	16.0	-4.4	4.7	12.2	0.9	2.1	-0.2	
Energjia	7.6%	4.9	5.0	4.3	1.2	8.4	0.4	4.1	
Mallrat tjerë	21.6%	0.3	2.4	0.7	3.9	4.6	4.4	2.9	
Shërbimet	32.7%	1.9	-2.5	1.9	3.2	1.5	1.5	-0.8	
<i>Inflacioni bazë, përjashtuar:</i>									
Ushqimin	61.9%	3.2	-0.6	1.6	2.5	2.1	0.9	0.5	
Ushqimin dhe energjinë	54.3%	2.8	-1.0	1.3	2.5	1.5	0.9	0.2	

Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së (2015)

Inflacioni bazë, i cili përjashton kategoritë të cilat karakterizohen me ndryshim më të theksuar të çmimeve, paraqet një pasqyrë më të qartë lidhur me inflacionin në Kosovë (figura 14). Më specifikisht, inflacioni bazë i cili përjashton ushqimin dhe energjinë, në vitin 2014 kishte normë prej 0.2 përqind krahasuar me normën prej 0.9 përqind sa ishte në vitin paraprak. Inflacioni bazë historikisht ka qenë më i ulët se sa inflacioni i përgjithshëm, ndërsa në vitin 2014 për shkak të rënies së çmimeve të ushqimit dallimi ndërmjet inflacionit bazë dhe inflacionit të përgjithshëm është më i vogël (tabela 1).

Figura 14. Inflacioni i përgjithshëm dhe inflacioni bazë, rritja vjetore në përqindje




Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së (2015)

4.2.2. Çmimet e mallrave dhe shërbimeve të tregtueshme dhe të pa tregtueshme³

Me qenë se ekonomia e Kosovës është ekonomi e vogël dhe e varur nga importi, është e natyrshme që komponentët e tregtueshëm të mallrave dhe shërbimeve të kenë një pjesëmarrje të lartë në IÇK dhe, rrjedhimisht, të përcaktojnë lëvizjen e nivelit të përgjithshëm të çmimeve. Komponentët e tregtueshëm përbëjnë rreth 81.9 përqind të shportës së konsumatorit kosovar, ndërsa komponentët e pa tregtueshëm (kryesisht shërbimet) përbëjnë rreth 18.1 përqind të shportës së konsumatorit (figura 15).

Figura 15. Komponentët e tregtueshëm dhe të patregtueshëm të IÇK-së




Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së (2015)

³ Komponentët e tregtueshëm konsiderohen mallrat dhe shërbimet të cilat tregtohen edhe në tregjet ndërkombëtare, ndërsa ato të patregtueshëm janë ato të cilat konsumohen vetëm brenda vendit. Rrjedhimisht, edhe faktorët që ndikojnë në çmime dallojnë te komponentët e tregtueshëm dhe ata të patregtueshëm. Komponentët e patregtueshëm ndikohen nga faktorët të tillë si kërkesa dhe oferta vendore, ndërsa komponentët e tregtueshëm përveç kërkesës dhe ofertës vendore ndikohen edhe nga çmimet ndërkombëtare të cilat përcaktohen nga kërkesa dhe oferta ndërkombëtare.

Çmimet e mallrave dhe shërbimeve të patregtueshme historikisht kanë qenë më stabile krahasuar me çmimet e mallrave të tregtueshme, që do të thotë se lëvizja e normës së inflacionit kryesisht është përcaktuar nga lëvizja e çmimeve të mallrave të tregtueshme (figura 16). Në vitin 2014, çmimet e mallrave dhe shërbimeve të patregtueshme shënuan rënie për 1.9 përqind, krahasuar me rritjen prej 1.2 përqind në vitin paraprak. Në anën tjetër, çmimet e mallrave dhe shërbimeve të tregtueshme shënuan rritje (0.4 përqind), por norma e rritjes ishte dukshëm më e ulët krahasuar me vitin paraprak (1.5 përqind). Rënia e çmimeve të mallrave dhe shërbimeve të tregtueshme është kryesisht për shkak të rënies së çmimeve të importit, ndërsa rënia e çmimeve të mallrave të patregtueshme përveç tjerash i atribuohet edhe aktivitetit më të ngadalësuar ekonomik në vitin 2014 krahasuar me vitin paraprak. Vendimi i qeverisë për uljen e tarifave për studentët e universiteteve publike por edhe rënia e çmimeve të importit në mënyrë indirekte, përmes lëndëve të para të importuara, mund të kenë ndikuar në rënien e çmimeve të mallrave të patregtueshme.

Figura 16. Indekset e komponentëve të tregtueshëm dhe të patregtueshëm




Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së (2015)

4.2.3. Çmimet e importit dhe çmimet e prodhimit

Lëvizjet e çmimeve në Kosovë janë mjaft të ngjashme me lëvizjet e çmimeve në tregjet ndërkombëtare si pasojë e varësisë së lartë të ekonomisë së Kosovës në importe. Kjo konfirmohet edhe nga sjellja e ngjashme e indeksit të çmimeve të importit me indeksin e çmimeve të konsumit (figura 17). Mesatarja e indeksit të çmimeve të importit në vitin 2014 ka shënuar rënie për 0.5 përqind (0.2 përqind rritje në vitin 2013). Çmimet e tekstilit kanë shënuar rënien më të lartë prej 24.1 përqind, pasuar nga mjetet e transportit me 7.4 përqind, si dhe artikujt ushqimorë me 6.7 përqind. Gjithashtu, produktet minerale (kryesisht nafta dhe derivatet e saj) të cilat janë kategoria kryesore e indeksit të çmimeve të importit (rreth 20 përqind e gjithsej indeksit) shënuan rënie për 6.9 përqind krahasuar me rënien prej 2.2 përqind të shënuar në vitin paraprak. Në anën tjetër, çmimet e produkteve bimore dhe këpucëve kanë shënuar rritjen më të lartë me 24.1 përkatësisht 17.0 përqind, pasuar nga metalet bazë me 12.1 përqind, pastaj produktet e industrisë kimike me 8.1 përqind, etj.

Figura 17. Indekset e çmimeve të konsumit, prodhimit dhe importit



Burimi: ASK (2015)

Çmimet e prodhimit, në vitin 2014, shënuan rritje për 1.6 përqind (2.4 përqind rritje në vitin 2013). Kjo rritje e çmimeve të prodhimit më së shumti është nxitur nga rritja e çmimeve të prodhimit të produkteve kimike të cilat shënuan rritje për 39.9 përqind, pastaj rritjes së çmimeve të prodhimit të drurit dhe produkteve të drurit për 12.9 përqind, prodhimi i tekstilit për 5.3

përqind, etj. Ndikimi i rritjes së çmimeve të këtyre kategorive në gjithsej çmimet e prodhimit u ndikua deri diku nga rënia e çmimeve të prodhimit të pajisjeve elektrike prej 17.1 përqind, pasuar nga rënia e çmimeve të nxjerrjes së xehes së metalit prej 15.2 përqind, prodhimi i letrës dhe produkteve të letrës prej 10.2 përqind. Rënie prej 1.1 përqind shënuan edhe çmimet e energjisë, të cilat kanë peshën kryesore në indeksin e çmimeve të prodhimit (26.2 përqind).


4.3. Zhvillimet Sektoriale

Energjetika

Sektori i energjisë gjatë vitit 2014 është karakterizuar me një performancë më të dobët krahasuar me vitin paraprak. Prodhimi i thëngjillit, si dhe prodhimi i energjisë në termocentrale ka shënuar rënie në vitin 2014 kundrejt vitit paraprak, përderisa vlenë të theksohet se prodhimi i energjisë në hidrocentrale ka shënuar rritje. Sasia e thëngjillit që nxirret nga minierat, dhe që përbën lëndën bazë djegëse për prodhim të energjisë elektrike në vend, është karakterizuar me rënie prej rreth 12 përqind. Në vitin 2014, me një rënie prej rreth 15 përqind është karakterizuar edhe energjia e prodhuar në termocentrale. Rënia e prodhimit të energjisë në vitin 2014 mund t'i atribuohet deri në një masë shpërthimit që ndodhi në qershor të vitit 2014 në Termocentralin Kosova A. Prodhimi i energjisë elektrike nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) në vitin 2014 është zvogëluar për rreth 6 përqind (figura 18).


Gjatë vitit 2014, vlera e energjisë elektrike të faturuar arriti në 219.3 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej rreth 5 përqind. Rritja e konsumit të energjisë elektrike në vitin 2014 është mbuluar kryesisht me import, vlera e të cilit arriti në 45.5 milionë euro dhe shënoi një rritje vjetore prej 49 përqind. Në të njëjtën kohë, eksporti i energjisë elektrike në vlerë prej 14.9 milionë euro, u karakterizua me rënie prej 34.5 përqind. Sektorët që rritën konsumin e energjisë në vitin 2014 ishin sektorët e industrisë, transportit dhe shërbimeve, përderisa sektori i amvisërisë dhe sektori i bujqësisë zvogëluan energjinë e konsumuar. Si pasojë e rritjes së importit dhe rënies së eksportit të energjisë elektrike, në vitin 2014 Kosova ka realizuar bilanc negativ të energjisë prej 400.3 GWh (bilanc pozitiv prej 335.1 GWh në vitin 2013), gjegjësisht bilanc negativ prej 29.6 milion euro (6.6 milion euro në vitin 2013). Gjatë kësaj periudhe, eksporti i energjisë kishte zbritur në vlerën prej 474.9 GWh (856.9 GWh në vitin 2013), ndërsa importi ka arritur nivelin prej 875.2 GWh (521.8 GWh në vitin 2013).

Figura 18. Prodhimi, konsumi dhe bilanci i energjisë (Giga watt për orë)



Burimi: ASK (2015)

Figura 19. Konsumi i energjisë sipas përdoruesit të fundit



Burimi: ASK (2015)

Pesha e prodhimit të energjisë në prodhimin e përgjithshëm në vend vazhdon të jetë e ulët, duke përfaqësuar vetëm 3 përqind të PBB-së.

Sipas sektorëve ekonomik, struktura e energjisë së konsumuar nuk ka ndryshuar nga periudhat paraprake. Sektori i amvisërisë dhe sektori i shërbimeve vazhdojnë të konsumojnë më shumë energjinë elektrike, përderisa sektori i transportit, bujqësisë dhe industrisë konsumojnë kryesisht produktet e naftës si produkte të energjisë.

Niveli i humbjeve në rrjet në sektorin e energjisë vazhdon të mbetet relativisht i lartë duke paraqitur rreth 40 përqind të gjithsej prodhimit në vitin 2014. Në vitin 2014, humbjet në rrjet kanë shënuar rënie, megjithëse si pjesëmarrje e gjithsej energjisë së prodhuar humbjet në rrjet janë rritur, kryesisht si pasojë e rënies së prodhimit.

Transporti⁴


Përderisa transporti hekurudhor i udhëtarëve në Kosovë ka qenë pothuajse i pandryshuar gjatë viteve të fundit, transporti hekurudhor i mallrave ka qenë më i luhatshëm. Megjithatë, gjatë vitit 2014 numri i pasagjerëve që kanë përdor transportin hekurudhor dhe vlera e mallrave të transportuara përmes hekurudhave vendore është karakterizuar me rënie. Numri i pasagjerëve që kanë përdorur transportin hekurudhor ishte 339 mijë veta apo 8.1 përqind më pak sesa në vitin paraprak. Në anën tjetër, sasia e mallrave të transportuara përmes hekurudhave të Kosovës gjatë vitit 2014 ishte 848 mijë tonë apo 6.2 përqind më pakë sesa në vitin paraprak.

Edhe transporti ajror gjatë viti 2014 është karakterizuar me rënie të numrit të udhëtarëve dhe fluturimeve. Numri i përgjithshëm i udhëtarëve që udhëtuan përmes transportit ajror ishte 1.4 milionë veta, që tregon për një rënie prej 13.8 përqind krahasuar me vitin paraprak, ndërsa numri prej 5,994 fluturimeve të realizuara gjatë vitit 2014 ishte për 17.9 përqind më i ulët krahasuar me vitin paraprak (figura 20).

Industria


Cikli i zhvillimit në sektorin e industrisë në Kosovë, prezantuar në formë të indeksit të qarkullimit të përgjithshëm industrial, përfaqësohet nga aktiviteti në industrinë nxjerrëse, industrinë përpunuese, furnizimi me rrymë, gaz, avull,

Figura 20. Transporti ajror në Kosovë



Burimi: ASK (2015)

Figura 21. Indeksi i qarkullimit industrial



Burimi: ASK (2015)

⁴ Në publikimin e ASK-së për statistikat e transportit, përveç transportit hekurudhor dhe atij ajror, nuk ekzistojnë të dhëna lidhur me transportin rrugor.

karakterizuan edhe ndërmarrjet që për aktivitet kanë hotelerinë, nga 9.7 përqind në 11.0 përqind të gjithsej ndërmarrjeve (figura 23).


Sa i përket madhësisë së ndërmarrjeve, kategoria e mikro ndërmarrjeve (1 – 9 të punësuar) përbënin rreth 99% të gjithsej ndërmarrjeve të reja të regjistruara në vitin 2014, 0.9 përqind e përbënin ndërmarrjet e vogla (10 – 49 të punësuar) dhe pjesa e mbetur prej 0.1 përqind apo rreth 8 ndërmarrjeve ishin ndërmarrjet të mesme dhe të mëdha. Krahasuar me vitin paraprak, vërehet një rritje e numrit të ndërmarrjeve të regjistruara në kuadër të kategorisë së ndërmarrjeve të vogla me 26 ndërmarrje më shumë, ndërsa mikro ndërmarrjet kanë shënuar rënie për rreth 42 ndërmarrje.

5. Sektori fiskal

Në vitin 2014, sektori fiskal u karakterizua me rritje të lehtë të të hyrave dhe nivel të ngjashëm të shpenzimeve të realizuara krahasuar me vitin paraprak. Të hyrat e përgjithshme buxhetore⁵ shënuan rritje prej 1.5 përqind dhe arritën vlerën prej 1.3 miliardë euro në vitin 2014. Në anën tjetër, vlera e përgjithshme e shpenzimeve buxhetore⁶ arriti në rreth 1.5 miliard euro, nivel pothuajse i njëjtë me vitin paraprak (1.5 miliard euro në vitin 2013). Rrjedhimisht, gjatë kësaj periudhe, buxheti i Kosovës regjistroi deficit primar prej rreth 131 milionë euro (2.4 përqind e PBB-së), krahasuar me deficitin prej 150 milionë euro të shënuar në vitin paraprak (2.9 përqind e PBB-së) (figura 24).


Gjatë vitit 2014, Kosova kishte shkallën më të ulët të ngarkesës së ekonomisë me tatime në rajon, pasi që raporti ndërmjet të hyrave buxhetore dhe PBB-së ishte 24.2 përqind krahasuar me mesataren e rajonit prej 37.0 përqind. Në të njëjtën periudhë, raporti i shpenzimeve buxhetore prej 26.6 përqind të PBB-së ishte më i ulët krahasuar me mesataren e rajonit prej 41.0 përqind. Përveç kësaj, Kosova vazhdon të ketë nivelin më të ulët edhe sa i përket ngarkesës me borxhe publike krahasuar me vendet e rajonit. Përderisa mesatarja e borxhit publik në EJL gjatë vitit 2014 ishte 57.3 përqind e PBB-së, ky raport në Kosovë ishte 10.6 përqind (figura 25).

Figura 24. Të hyrat dhe shpenzimet buxhetore, në milionë euro



Burimi: MF dhe kalkulimet e BQK-së (2015)

Figura 25. Treguesit kryesor fiskal të EJL-së në vitin 2014 si përqindje e PBB-së




Burimi: FMN për vendet e rajonit, MF dhe kalkulimet e BQK-së për Kosovën (2015)

⁵ Në kuadër të të hyrave buxhetore nuk janë përfshirë pranimet nga grantet e përcaktuara të donatorëve, huazimet e brendshme dhe të jashtme, të hyrat nga privatizimi.
⁶ Në kuadër të shpenzimeve buxhetore nuk janë përfshirë pagesat nga grantet e përcaktuara të donatorëve, pagesat e borxhit, si dhe kthimi i huazimeve nga ndërmarrjet publike trajtohet si zvogëlim i shpenzimeve buxhetore.

5.1. Të hyrat buxhetore

Të hyrat primare buxhetore në vitin 2014 arritën vlerën bruto prej 1.37 miliardë euro. Nëse përjashtohen 33.5 milionë euro kthime të TVSH-së dhe tatimeve tjera nga Dogana e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës, atëherë të hyrat primare buxhetore shënojnë vlerën neto prej 1.33 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 1.5 përqind. Ky nivel më i lartë i të hyrave është arritur përkundër faktit se në vitin 2014 janë arkëtuar vetëm 15.0 milionë euro të hyra në formë të dividendës nga ndërmarrjet publike, ndërkohë që në vitin e kaluar ishin realizuar 43.0 milionë euro të hyra nga dividenda. Nëse përjashtohen të hyrat nga dividenda, atëherë të hyrat buxhetore në vitin 2014 shënuan rritje prej 3.8 përqind.


Figura 26. Struktura e të hyrave buxhetor, në milionë euro



Burimi: MF dhe kalkulimet e BQK-së (2015)

Të hyrat buxhetore në Kosovë përbëhen kryesisht nga të hyrat tatimore, të cilat në vitin 2014 kishin një pjesëmarrje prej rreth 85.6 përqind në gjithsej të hyrat buxhetore. Të hyrat vetanake përbëjnë 7.4 përqind të gjithsej të hyrave (62 përqind janë të komunave dhe 38 përqind të qeverisë qendrore), të hyrat jo-tatimore përbëjnë 3.5 përqind të gjithsej të hyrave dhe 3.5 përqind janë të hyra të tjera. Rritja e të hyrave buxhetore në vitin 2014 u realizua përkundër arkëtimit më të ulët të të hyrave në formë të dividendës nga ndërmarrjet publike prej vetëm 15 milion euro, përderisa në vitin paraprak ishin realizuar 43.0 milionë euro të hyra nga dividenda. Nëse përjashtohen të hyrat nga dividenda, atëherë të hyrat buxhetore shënuan një rritje prej 3.8 përqind në vitin 2014.

Figura 27. Të hyrat vendore neto sipas llojeve kryesore të tatimeve, në milionë euro



Burimi: MF dhe kalkulimet e BQK-së (2015)


Të hyrat tatimore shënuan rritje për 3.3 përqind dhe arritën vlerën prej 1.1 miliard euro. Në kuadër të të hyrave tatimore, të hyrat nga tatimet kufitare shënuan rritje vjetore prej 4.0 përqind dhe arritën vlerën bruto prej 871.0 milionë euro. Të hyrat neto të cilat përjashtojnë kthimet e doganës prej 2.4 milionë euro arritën vlerën prej 868.6 milionë euro. Në të njëjtën kohë, të hyrat e mbledhura nga tatimet vendore arritën vlerën bruto prej 303.7 milionë euro. Nëse përjashtohen kthimet e administratës tatimore prej 31.1 milionë euro atëherë të hyrat neto nga tatimet vendore shënuan rritje prej 0.7 përqind dhe arritën vlerën prej 272.6 milionë euro. Në kuadër të të hyrave buxhetore, të hyrat vetanake në nivel qendror dhe lokal shënuan një rritje prej 3.4 përqind, duke arritur vlerën prej 98.2 milionë euro, përderisa të hyrat jo tatimore ishin më të larta për 8.0 përqind dhe kishin një vlerë prej 46.7 milionë euro (figura 26).

Në vitin 2014, në kuadër të tatimeve vendore, me rritje u karakterizuan tatimi në të ardhurat personale dhe tatimi i bizneseve individuale me 9.9 përkatësisht 10.4 përqind, ndërsa të hyrat nga TVSH-ja dhe tatimi mbi të ardhurat e korporatave shënuan rënie për 11.6 përkatësisht 13.1 përqind. (figura 27).

Performanca pozitive e tatimeve kufitare reflekton kryesisht rritjen e nivelit të importeve gjatë kësaj periudhe. Në kuadër të të hyrave kufitare, kategoria kryesore mbetet TVSH-ja, me një pjesëmarrje prej 48.7 përqind të gjithë të hyrave kufitare. Të hyrat nga TVSH-ja e mbledhur në kufi u karakterizuan me rritje prej 2.9 përqind dhe arritën vlerën neto prej 422.8 milionë euro në vitin 2014 (figura 28).

Të hyrat kufitare nga akciza, që në vitin 2014 kishin një pjesëmarrje prej 35 përqind në gjithë të hyrat kufitare, shënuan rritje prej 6 përqind dhe arritën vlerën neto prej 304 milionë euro. Të hyrat nga tatimi doganor që përfaqësojnë 14.5 përqind të gjithë të hyrave kufitare, arritën vlerën neto prej 125.6 milionë euro në vitin 2014 dhe shënuan një rritje vjetore prej 5.4 përqind.

Figura 28. Të hyrat kufitare neto sipas llojeve të tatimeve, në milionë euro




Burimi: MF dhe kalkulimet e BQK-së (2015)

5.2. Shpenzimet buxhetore

Vlera e përgjithshme e shpenzimeve buxhetore arriti në 1.5 miliard euro, që paraqet një nivel pothuajse të njëjtë me vitin paraprak. Shpenzimet rrjedhëse, që kryesisht përbëhen nga pagat dhe mëditjet, mallrat dhe shërbimet, dhe subvencionet dhe transferet arritën vlerën prej 1.1 miliard euro, që korrespondon me një rritje vjetore prej 11.9 përqind. Si rezultat i rritjes së pagave dhe pensioneve është rritur edhe pjesëmarrja e shpenzimeve rrjedhëse në kuadër të gjithë shpenzimeve, nga 64.2 përqind sa ishte në vitin 2013, ka arritur në 71.9 përqind në vitin 2014 (figura 29). Shpenzimet qeveritare për paga dhe mëditje u karakterizuan me një rritje vjetore prej 17.3 përqind, duke arritur në 485.2 milionë euro. Kjo rritje e kategorisë së pagave dhe mëditjeve ka ndikuar që pjesëmarrja e kësaj kategorie të arrijë në 33.2 përqind e gjithë shpenzimeve në vitin 2014 nga 28.3 përqind sa ishte në vitin paraprak. Me rritje u karakterizuan edhe kategoria e subvencioneve dhe transfereve, të cilat shënuan rritje vjetore prej 15.4 përqind dhe arritën vlerën prej 361.2 milion euro në vitin 2014. Pjesëmarrja e kategorisë së subvencioneve dhe transfereve në gjithë shpenzimet është rritur për 3.3 pikë përqindje dhe ka arritur në 24.7 përqind të gjithë shpenzimeve. Në anën tjetër, shpenzimet qeveritare për mallra dhe shërbime kishin vlerën prej 205.8 milionë euro, që përkon me një rënie vjetore prej 3.6 përqind, gjë që ka ndikuar që edhe pjesëmarrja e kësaj kategorie të zvogëloj pjesëmarrjen në gjithë shpenzimet nga 14.6 përqind sa ishte në vitin 2013 në 14.1 përqind në vitin 2014.

Figura 29. Struktura e shpenzimeve buxhetore, në milionë euro



Burimi: MF dhe kalkulimet e BQK-së (2015)


Në vitin 2014, shpenzimet qeveritare për investime kapitale shënuan vlerën prej 411.4 milionë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 22.3 përqind. Rënia e investimeve kapitale kryesisht i atribuohet zvogëlimit të shpenzimeve të parapara për investime publike, si rezultat i rritjes së shpenzimeve rrjedhëse të qeverisë të cilat e kanë kufizuar hapësirën për investime kapitale por edhe vonesës së krijimit të institucioneve pas zgjedhjeve të 8 qershorit 2014, vonesë e cila ndikoj në shtyrjen e realizimit të projekteve kapitale. Shpenzimet kapitale të cilat historikisht kanë qenë kategoria me pjesëmarrjen më të lartë në gjithsej shpenzimet, në vitin 2014 kanë kaluar në vendin e dytë pas kategorisë së pagave dhe mëditjeve. Me fjalë të tjera, investimet kapitale e kanë zvogëluar pjesëmarrjen nga 36.2 përqind e gjithsej shpenzimeve në vitin 2013 në 28.1 përqind në vitin 2014.

Sa i përket ekzekutimit të shpenzimeve të planifikuara në vitin 2014 krahasuar me vitin paraprak u shënuan nivel pothuajse i njëjtë i ekzekutimit të shpenzimeve (91 përqind e planit vjetor). Pagat dhe mëditjet si dhe subvencionet dhe transferet shënuan nivel më të mirë të realizimit krahasuar me planin, ndërsa shpenzimet kapitale u realizuan në masën prej 80.0 përqind të planit krahasuar me shkallën prej 84.4 përqind të realizimit në vitin paraprak.

5.3. Borxhi publik

Në fund të vitit 2014, stoku i borxhit publik të qeverisë shënoi vlerën prej 582.9 milionë euro apo 10.6 përqind e PBB-së krahasuar me 476.3 milionë euro apo 9.1 përqind e PBB-së në fund të vitit 2013 (figura 30). Ky nivel i borxhit publik e bënë Kosovën vendin me shkallën më të ulët të borxhit publik krahasuar me vendet e rajonit. Në vitin 2014, mesatarja e borxhit publik në vendet e EJT-së ishte rreth 57.3 përqind e PBB-së, përdërisa Kosova kishte nivelin prej 10.6 përqind. Gjithashtu, borxhi publik në raport me PBB-në në vendet e rajonit është rritur për mesatarisht 2.1 pikë përqindje gjatë vitit 2014, ndërsa në Kosovë rritja e borxhit publik në raport me PBB-në ka qenë më e ngadalshme, me vetëm 1.5 pikë përqindje.

Figura 30. Borxhi publik, në milionë euro



Burimi: MF (2015)

Gjithsej borxhit publik përbëhet nga 326.3 milionë euro borxh ndërkombëtar ndërsa pjesa tjetër prej 256.5 milionë euro borxh i brendshëm. Përkundër faktit se borxhi publik si përqindje e PBB-së është i ulët, në dy vitet e fundit është shënuar rritje e konsiderueshme e tij, gjë që reflekton nevojat në rritje për financimin e deficitit buxhetor. Në vitin 2014 borxhi publik ka shënuar rritje prej 22.4 përqind krahasuar me vitin paraprak. Siç edhe është paraqitur në figurën 30, kjo rritje e borxhit publik i atribuohet kryesisht borxhit të brendshëm i cili ka shënuar rritje prej 68.2 përqind dhe ka arritur në 256.5 milionë euro ndërsa borxhi publik ndërkombëtar ka mbetur pothuajse i pandryshuar.

Sa i përket borxhit të brendshëm publik, ai i përket në tërësi nivelit qendrorë ndërsa niveli komunal ende nuk ka filluar një proces të tillë. Sa i përket instrumenteve⁷, borxhi i brendshëm publik në fund të vitit 2014 ishte kryesisht në bono thesari (80 përqind) dhe pjesa tjetër prej 20 përqind është në obligacione. Bono thesari 12 mujore paraqesin kategorinë kryesore me rreth 54

⁷ Instrumentet financiare ndahen në instrumente të tregut të parasë dhe tregut të kapitalit. Kjo ndarje bëhet varësisht nga kohëzgjatja e maturimit të instrumenteve të caktuara. Në tregun e parasë hynë instrumentet financiare afatshkurta (bono të thesarit), ndërsa në tregun e kapitalit ato afatgjata (obligacionet).

përqind të gjithë borxhit të brendshëm publik, pasuar nga bono thesari 6 mujore (22 përqind), dhe bono thesari 3 mujore (4 përqind). ndërsa një pjesë më e vogël

6. Sistemi financiar


Në vitin 2014, shkalla e ndërmjetësimit financiar në vend, gjegjësisht raporti i aseteve të sistemit financiar ndaj PBB-së u thellua, duke arritur në 81.3 përqind (79.4 përqind në vitin 2013). Gjithsej asetet e sistemit financiar arritën vlerën prej 4.5 miliardë euro në vitin 2014, duke shënuar rritje vjetore prej 7.4 përqind, rritje që kryesisht i atribuohet rritjes së aseteve të bankave komerciale dhe fondeve pensionale, përderisa sektori i sigurimeve dhe sektori mikrofinanciar kishin kontribut të vogël gjegjësisht neutral në rritjen e përgjithshme të aseteve.

Në kuadër të sektorit bankar, kreditë vazhdojnë të jenë kategoria kryesore e me pjesëmarrje prej 59.1 përqind në gjithsej asetet e sektorit në vitin 2014. Dinamika e aktivitetit kreditues në vend vlerësohet të ketë qenë në nivelin më të lartë në tri vitet e fundit. Në vitin 2014, vlera e gjithsej kredive arriti në 1.9 miliardë euro, që paraqet rritje vjetore prej 4.2 përqind (2.4 përqind në vitin 2013) (figura 31). Trendi i përshpejtuar i rritjes së kreditimit që karakterizoi vitin 2014 dhe muajt e parë të vitit 2015 i atribuohet kryesisht ofertës më të lehtësuar kredituese të bankave, përderisa kërkesa raportohet të ketë qenë më e ulët nga ndërmarrjet e mëdha, por më e lartë nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) dhe ekonomitë familjare. Bazuar në Anketën e Kreditimit Bankar, faktorët kryesorë që shpjegojnë politikën më të lehtësuara bankare të kreditimit ishin pozita e kënaqshme e likuiditetit të bankave komerciale, konkurrenca në sistemin financiar dhe pritjet e bankave mbi zhvillimet ekonomike në vend. Kërkesa për kredi u raportua të jetë rritur nga NVM-të dhe ekonomitë familjare, përderisa ka pasur rënie të kërkesës për kredi nga ndërmarrjet e mëdha. Rritja e kërkesës për kredi, veçanërisht nga ekonomitë familjare, ishte në linjë me rritjen e konsumit të brendshëm gjatë kësaj periudhe, e që mund të jetë nxitur nga rritja e pagave dhe mëditjeve për shërbyesit civil në prill 2014, zhvillimeve në tregun e pasurive të paluajtshme, dhe rënies së vazhdueshme të normave të interesit në kredi.

Megjithatë, përkundër ritmit të përshpejtuar të rritjes së kreditimit në vitin 2014, niveli i ndërmjetësimit financiar të ekonomisë duhet të thellohet më tutje, pasi që aktiviteti kreditues në raport me PBB-në mbetet në nivelin më të ulët në rajon. Raporti i kredive të sektorit bankar për sektorin privat në Kosovë ndaj PBB-së në vitin 2014 ishte rreth 34 përqind, përderisa mesatarja në vendet e rajonit ishte rreth 47 përqind. Kjo sugjeron se, në raport me madhësinë e ekonomisë, ka hapësirë të konsiderueshme për zgjerim të mëtejshëm të aktivitetit kreditor nga sektori bankar. Duke qenë se struktura e kredive të sektorit bankar vazhdon të dominohet nga kreditë për sektorin e tregtisë, rritja e mbështetjes financiare për ndërmarrjet që veprojnë në sektorët si bujqësia, prodhimi, energjetika, minierat, etj., do të ndikonte në rritjen e aktivitetit ekonomik në këta sektor dhe rrjedhimisht në rritjen e aktivitetit të përgjithshëm ekonomik në vend. Rritja e mbështetjes për sektorët më pak të kredituar nga sektori bankar në vend, përveç që do ndikojë në rritjen e raportit të kredive ndaj PBB-së, do të diversifikojë portfolion kreditor duke ndikuar kështu në zvogëlimin e rrezikut sektorial.

Në kuadër të strukturës së kredive, vërehet një rritje e më e madhe e përkrahjes së NVM-ve përmes standardeve më të lehtësuara kreditore, sidomos në sektorët më pak të kredituar më

Figura 31. Norma e rritjes së kredive sipas sektorëve, në përqindje



Burimi: BQK (2015)


parë si bujqësia dhe prodhimi. Gjithashtu, në vitin 2014 është vënë re një rritje e kreditimit afatgjatë, që tregon për një lëvizje graduale të bankave nga qasja konservatore drejtë alternativave që mundësojnë zgjerim më të madh të afarizmit të tyre.

Sektorët ekonomik që u karakterizuan me rritje më të shpejtë të kreditimit në vitin 2014 ishin prodhimitaria (13.1 përqind), bujqësia (7.9 përqind) dhe sektori i tregtisë (3.6 përqind) (figura 32). Rritja e kreditimit të këtyre tre sektorëve të ekonomisë kryesisht reflekton rënien e kostos së financimit gjatë kësaj periudhe. Në të njëjtën periudhë, zvogëlimi i mbështetjes financiare për sektorët si ndërtimtaria (rënie vjetore prej 12.2 përqind), energjetika (rënie vjetore prej 17.8 përqind) dhe minierat (rënie prej 2.2 përqind) ishte kryesisht pasojë e rënies, përkatësisht ngadalësimit të aktivitetit në sektorët përkatës.

Burimi kryesor i financimit për sektorin bankar vazhdojnë të mbeten depozitat, që në vitin 2014 shënuan rritje vjetore prej 3.6 përqind. Depozitat e sektorit bankar në vend arritën vlerën prej 2.53 miliard euro në vitin 2014 dhe përfaqësuan 79.6 përqind të gjithë detyrimeve të sektorit. Në vitin 2014, depozitat u karakterizuan me ngadalësim të trendit të rritjes, që kryesisht është pasojë e rënies së theksuar të normës së interesit në depozita gjatë kësaj periudhe. Ngadalësimi i rritjes së depozitave mund të jetë ndikuar edhe nga rritja e emigrimit nga Kosova në muajt e fundit të vitit 2014.


Aktiviteti i sektorit bankar gjatë vitit 2014 u karakterizua me një zvogëlim të theksuar të normave të interesit në kredi dhe depozita. Norma mesatare e interesit në kredi u zvogëluar në 9.2 përqind në vitin 2014 nga 11.1 përqind sa ishte në vitin 2013 (figura 33), duke krijuar kështu mundësi më të mira financimi për rritjen e konsumit dhe investimeve në vend. Zvogëlimi i normës së interesit në kredi kryesisht reflekton zvogëlimin e normës së interesit në depozita gjatë kësaj periudhe, por edhe rritjen e presioneve konkurruese në tregun bankar në vend. Norma mesatare e interesit në depozita në vitin 2014 u zvogëluar në 1.1 përqind nga 2.4 përqind

Figura 32. Trendi i rritjes së kredive sipas sektorëve ekonomik, në përqindje




Burimi: BQK (2014)

Figura 33. Mesatarja vjetore e normave të interesit, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

Figura 34. Treguesit e profitabilitetit




Burimi: BQK (2015)

mjaftueshme të likuiditetit në sektorin bankar. Rrjedhimisht, dallimi në mes të normave të interesit në kredi dhe depozita u zvogëluar në 8.1 pp në vitin 2014, nga 8.7 pp sa ishte në vitin 2013.

Në vitin 2014, performanca financiare e sektorit bankar u përmirësua dukshëm, duke shënuar fitim neto në vlerë prej 60.1 milionë euro, përdërisa neto profiti i shënuar në vitin 2013 ishte 26.0 milionë euro (figura 34). Rritja e profitit të sektorit bankar gjatë vitit 2014 ishte si rezultat i reduktimit të shpenzimeve, veçanërisht atyre për provizione (mbulimin e humbjeve të mundshme nga kreditë) dhe shpenzimeve të interesit në depozita, përdërisa të hyrat e sektorit bankar shënuan rënie të lehtë.

Sektorin bankar i Kosovës vazhdon të ketë nivel të lartë të qëndrueshmërisë, të shprehur me menaxhim të mirë të rreziqeve bankare. Në vitin 2014, treguesit kyç të likuiditetit u karakterizuan me rritje, gjë që ndikoi në përmirësimin e pozitës së likuiditetit të sektorit bankar. Gjithashtu, sektori bankar është karakterizuar në vazhdimësi me nivel të lartë të kapitalizimit, duke tejkaluar kërkesat minimale rregullative. Gjatë vitit 2014, ekspozimi i sektorit bankar të Kosovës ndaj rrezikut kreditor ka treguar tendencë rënëse, ku raporti i kredive joperformuese (angl. Non-Performing Loans: NPL) ndaj gjithsej kredive ka zbritur në 8.3 përqind nga 8.7 përqind në dhjetor 2013 (figura 35). Në rënie e raportit të kredive joperformuese ka kontribuar përmirësimi i cilësisë së portofolios kreditorë (që reflektohet nga norma më e ngadalshme e rritjes vjetore të vlerës së NPL-ve) si dhe rritja më e shpejtë e stokut të kredive në vitin 2014.

Figura 35. NPL-të dhe provizionet



Burimi: BQK (2015)

7. Sektori i jashtëm

Rikuperimi i kërkesës së jashtme veçanërisht në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe në disa nga vendet e eurozonës është reflektuar në rritje të eksporteve të Kosovës në vitin 2014 kundrejt vitit paraprak. Megjithatë, rritja e kërkesës së brendshme në vend ka çuar në rritjen e vlerës së gjithsej importeve, duke ndikuar kështu në përkeqësim të pozicionit të neto eksporteve në vend. Bilanci i pagesave në Kosovë u karakterizua me rritje të deficitit në llogarinë rrjedhëse dhe kapitale. Në anën tjetër, llogaria financiare regjistroi një bilanc përafërsisht të ngjashëm me vitin paraprak.

7.1 Llogaria rrjedhëse dhe llogaria kapitale

Një ndër problemet kryesore të ekonomisë së Kosovës mbetet shkalla e lartë e deficitit tregtarë. Përmirësimi i bilancit tregtarë kërkon rritje të mëtejme të kapaciteteve prodhuese në vend dhe rritje të konkurrueshmërisë së produkteve vendore si brenda vendit ashtu edhe në tregun e jashtëm, si mënyrë për të përmirësuar pozicionin e neto eksportit.

Dinamika e zhvillimeve në llogarinë rrjedhëse të Kosovës vazhdon të përcaktohet kryesisht nga zhvillimet në bilancin tregtar të vendit. Në vitin 2014,


pozicioni i llogarisë rrjedhëse në Kosovë u përkeqësua si pasojë e rritjes së deficitit në tregtinë e mallrave, përderisa bilanci pozitiv në tregtinë e shërbimeve dhe të kategorive siç janë të ardhurat primare dhe sekondare vazhdojnë të kontribuojnë në ngushtimin e këtij deficiti (figura 36). Deficiti prej 415.8 milionë euro i llogarisë rrjedhëse dhe kapitale ka rritur në 7.6 përqind të PBB-së nga 5.7 përqind sa ishte në vitin paraprak. Rritja e deficitit të llogarisë rrjedhëse gjatë kësaj periudhe ishte kryesisht pasojë e rritjes së deficitit tregtar, si dhe zvogëlimit të bilancit pozitiv të llogarisë së të ardhurave primare dhe sekondare.⁸

Bilanci i llogarisë kapitale⁹ u zvogëlua në 21.2 milionë euro në vitin 2014, nga 34.7 milionë euro sa ishte në vitin paraprak, gjë që i atribuohet zvogëlimit të granteve për investime kapitale gjatë kësaj periudhe.

Mallrat dhe shërbimet

Ekonomia e Kosovës u karakterizua me rritje të aktivitetit tregtar në vitin 2014, gjegjësisht me rritje të vlerës së gjithsej eksporteve dhe importeve. Duke arritur vlerën prej 1.7 miliard euro (rreth 31 përqind e PBB-së), deficiti tregtar në mallra dhe shërbime ishte më i lartë për 2.3 përqind në vitin 2014 kundrejt vitit paraprak. Përkundër rritjes së eksportit të mallrave, baza ende e ulët e tyre kundrejt vlerës së importit të mallrave ka ndikuar që deficiti tregtar të shënojë rritje. Në anën tjetër, llogaria e shërbimeve u karakterizua me rritje të bilancit pozitiv në vitin

Figura 36. Bilanci i llogarisë rrjedhëse, në milionë euro



Burimi: BQK (2015)

⁸ Në kuadër të Bilancit të Pagesave të Kosovës, llogaria e të ardhurave parësore përfshinë kategoritë "Kompenzimi i punonjësve" dhe "Të ardhurat nga investimet". Llogaria e të ardhurave dytësore përbëhet nga "Transferet Qeveritare" dhe "Transferet Private – që dominohen nga remitencat".

⁹ Llogaria kapitale paraqet të gjitha transaksionet që involvojnë pranimet ose pagesat e (1) transfertave kapitale dhe (2) transaksionet në mjetet jo prodhuese - jo financiare (siç janë patentat, dhe të drejtat e autorit).

2014, kryesisht si rezultat i rritjes së eksportit të shërbimeve gjatë kësaj periudhe, që njëkohësisht kanë edhe vlerën më të lartë kundrejt shërbimeve të importuara. Në vitin 2014, shkalla e hapjes tregtare, gjegjësisht raporti i aktivitetit tregtar të Kosovës ndaj PBB-së arriti në rreth 71 përqind, nga 66 përqind sa ishte në vitin paraprak.


Mallrat

Deficiti në llogarinë e mallrave shënoi vlerën 2.1 miliard euro në vitin 2014, që paraqet një rritje vjetore prej 3.2 përqind (figura 37). Rritja më e lartë e eksportit të mallrave krahasuar me importin ka ndikuar që raporti i mbulimit të importeve me eksporte të rritet në 12.8 përqind në vitin 2014, nga 12.0 përqind sa ishte në vitin paraprak.

Gjatë vitit 2014, gjithsej eksportet e Kosovës shënuan vlerën prej 324.5 milionë euro që paraqet rritje vjetore prej 10.4 përqind. Rritja e vlerës së eksportit të mallrave në vitin 2014 i atribuohet kryesisht rritjes së përgjithshme të kërkesës në rajon dhe në vendet e BE-së, rritjes së çmimeve në tregjet ndërkombëtare të njërit prej metaleve kryesore që eksporton Kosova (nikelit) (figura 38), si dhe rritjes së aktivitetit në disa sektorë të ekonomisë gjatë kësaj periudhe. Pjesëmarrja e eksporteve të Kosovës në gjithsej PBB vijoi të mbetet e ulët prej vetëm rreth 6.1 përqind në vitin 2014.


Struktura e eksporteve të Kosovës vazhdon të dominohet nga kategoria e metaleve bazë, e cila në vitin 2014 rriti pjesëmarrjen në gjithsej eksportet në rreth 52 përqind nga 49 përqind sa ishte në vitin paraprak (figura 39). Vlera e gjithsej eksporteve të metaleve bazë në vitin 2014 arriti në 167.4 milionë euro, nga 143.9 milionë sa ishte në vitin 2013. Rritja e eksportit të këtyre mallrave ishte kryesisht rezultat i rritjes së çmimeve të metaleve të nikelit në tregjet ndërkombëtare gjatë kësaj periudhe. Me rritje të vlerës u karakterizuan edhe eksportet e produkteve bujqësore, pijeve dhe duhanit, produkteve të tekstilit, eksportet e makinerive, paisjeve mekanike dhe elektrike dhe eksportet e produkteve kimike. Rritja e eksporteve të këtyre kategorive mund ti atribuohet deri në një masë rritjes së aktivitetit në industrinë përpunuese në periudhën raportuese. Në anën tjetër, eksportet e produkteve minerale, të cilat kanë një pjesëmarrje prej 13.8 përqind në gjithsej eksportet e vendit, u karakterizuan me rënie të vlerës në 44.7 milionë euro në vitin 2014 nga 46.3 milionë euro sa ishin në vitin 2013. Rënia e vlerës së eksporteve të produkteve minerale në vitin 2014 mund ti atribuohet kryesisht rënies së prodhimit dhe, si pasojë, rënies së eksportit të energjisë elektrike në periudhën raportuese.

Figura 37. Importet, eksportet dhe bilanci tregtar, jo kumulative në milionë euro



Burimi: ASK (2015)

Figura 38. Gjithsej eksportet (jo kumulative) dhe çmimet ndërkombëtare të metaleve



Burimi: FMN (2015) dhe ASK (2015)


Vlera e gjithsej mallrave të importuara në Kosovë në vitin 2014 ishte 2.5 miliardë euro (46 përqind e PBB-së), që paraqet një rritje vjetore prej 3.6 përqind. Trendi i rritjes së vlerës së gjithsej importeve gjatë vitit 2014 u ndikua negativisht nga rënia e çmimeve të produkteve kryesore të importit, konkretisht produkteve minerale, produkteve ushqimore dhe disa nga metalet që importon Kosova (figura 40).

Vlera e importeve të produkteve minerale, që kanë njëherësh edhe pjesëmarrjen më të lartë në gjithsej importet në vend (18.4 përqind në vitin 2014) dhe që kryesisht dominohen nga nafta, shënoi rënie gjatë kësaj periudhe në 467.8 milionë euro nga 480.6 milionë euro sa ishte në vitin 2013 (figura 41). Me rënie u karakterizua edhe vlera e gjithsej importeve të metaleve bazë (228 milionë euro në vitin 2014 nga 247.2 milionë euro në vitin 2013), rënie që i atribuohet kryesisht rënies së çmimeve të metaleve (plumbit, hekurit dhe zinkut) në këtë periudhë. Në anën tjetër, rritja e vlerës së importeve të produkteve kimike, importeve të mjeteve të transportit, makinerive, paisjeve mekanike dhe importeve të produkteve të tekstilit në vitin 2014 i atribuohet rritjes së aktivitetit në industrinë përpunuese në periudhën raportuese.

Në kuadër të strukturës së importeve, pjesëmarrja e mallrave kapitale prej 8.9 përqind mbetet e ulët, megjithëse në vitin 2014 u karakterizuan me një rritje vjetore prej 12.9 përqind. Në vitin 2014, vlera e importit të mallrave të ndërmjetme është zvogëluar krahasuar me vitin paraprak për 2.3 përqind, përderisa vlera e importit të mallrave të konsumit gjatë kësaj periudhe është rritur për 12.1 përqind. Mallrat e ndërmjetme vazhdojnë të kenë pjesëmarrjen më të lartë në kuadër të strukturës së gjithsej mallrave të importuara në vend (rreth 50 përqind), përderisa mallrat për konsum kanë një pjesëmarrje prej rreth 35 përqind. Pjesëmarrja e mbetur prej rreth 6 përqind i takon mallrave të pa kategorizuara të importit.


Partnerët kryesor tregtarë të Kosovës në vitin 2014 ishin shtetet e BE-së dhe vendet e Ballkanit Perëndimor. Importet me origjinë nga BE-ja përfaqësojnë 43 përqind të gjithsej importeve të Kosovës. Në vitin 2014, pjesa më e madhe e importeve ka ardhur nga Gjermania, Italia dhe

Figura 39. Struktura e eksporteve sipas kategorive, në përqindje




Burimi: ASK (2015)

Figura 40. Struktura e importeve sipas kategorive, në përqindje



Burimi: ASK (2015)

Figura 41. Gjithsej importet (jo kumulative) dhe çmimet ndërkombëtare të naftës dhe ushqimit




Burimi: ASK (2015) dhe IFS dhe FAOUN

Greqia. Në kuadër të vendeve tjera evropiane dhe vendeve nga Azia, Kosova importon sasi të konsiderueshme të mallrave nga Turqia dhe Kina. Ndërkaq, në kuadër të vendeve të rajonit, pjesa më e madhe e importeve të Kosovës vjen nga Serbia, Shqipëria dhe Maqedonia.

Në anën tjetër, eksportet e Kosovës në vendet e BE-së përfshijnë rreth 30 përqind të gjithëj eksporteve të Kosovës dhe janë të përqendruara kryesisht në Itali dhe në masë më të vogël në Gjermani. Sa i përket vendeve të rajonit, Kosova vazhdon të eksportojë më shumë në Shqipëri, Serbi dhe Maqedoni. Një pjesëmarrje e konsiderueshme e eksporteve të Kosovës ka për destinacion edhe Kinën, Indinë dhe Turqinë (figura 42).

Sikurse në periudhat paraprake, Kosova vazhdon të importojë produktet minerale kryesisht nga Italia dhe Greqia, përderisa nga Gjermania importon makineri, pajisje mekanike dhe elektrike, mjete të transportit, produkte të plastikës, duhan etj. Nga partnerët tregtar të rajonit, gjegjësisht nga Serbia dhe Maqedonia, Kosova importon kryesisht produkte minerale, pajisje mekanike dhe elektrike, produkte të qeramikës, pije dhe produkte ushqimore, etj. Nga vendet tjera evropiane dhe Azia, konkretisht nga Turqia dhe Kina, importi përbëhet kryesisht nga produktet e hekurit dhe çelikut, pajisjet mekanike dhe elektrike, produktet e qeramikës, tekstilit, etj. Sa i përket eksporteve, në Shqipëri vazhdon të eksportohet kryesisht hekur dhe çelik si dhe artikuj të tyre, metale bazë, produkte të plastikës, pije, produkte minerale, etj. Në Mal të Zi dhe Maqedoni, Kosova eksporton kryesisht metale bazë, duhan, produkte të tekstilit, artikuj të letrës, artikuj të gurit dhe qeramikës, etj.

Figura 42. Struktura e eksporteve dhe importeve sipas shteteve, në përqindje




Burimi: ASK (2015)

Shërbimet

Bilanci i shërbimeve në vitin 2014 kishte vlerën prej 335.9 milionë euro, që paraqet një rritje prej 7.6 përqind krahasuar me bilancin e shënuar në vitin paraprak. Rritja e bilancit të llogarisë së shërbimeve në këtë periudhë kryesisht reflekton rritjen e konsiderueshme të të hyrave nga shitja e shërbimeve ndaj jorezidentëve, përderisa me rritje u karakterizuan edhe pagesat e rezidentëve kosovarë ndaj jo rezidentëve. Eksporti i shërbimeve arriti vlerën prej 767.2 milionë euro, një rritje prej 21.3 përqind krahasuar me vitin paraprak. Ndërsa, importi i shërbimeve arriti vlerën prej 431.3 milionë euro, që paraqet një rritje të shpenzimeve krahasuar me vitin paraprak prej 34.6 përqind.

Figura 43. Struktura e neto eksportit të shërbimeve, në milionë euro



Burimi: BQK (2015)

Në kuadër të bilancit të shërbimeve, kategoria kryesore vazhdon të jetë kategoria e udhëtimit (figura 43). Në vitin 2014, bilanci i llogarisë së shërbimeve të udhëtimit arriti në 378.8 milionë

euro, që krahasuar me vitin paraprak paraqet një rritje vjetore prej 24.5 përqind. Megjithëse shërbimet e udhëtimit u karakterizuan me rritje si të eksportit ashtu edhe të importit, pesha më e lartë e eksporteve në kategorinë e udhëtimit ndikoi që bilanci i përgjithshëm i shërbimeve të udhëtimit të shënojë rritje. Të hyrat nga shërbimet e udhëtimit arritën vlerën prej 504.2 milionë euro, një rritje vjetore prej 24.6 përqind, dhe kryesisht përbëhen prej shpenzimeve të jorezidentëve gjatë qëndrimit në Kosovë. Në të njëjtën periudhë, pagesat për shërbimet e udhëtimit të rezidentëve kosovarë arritën vlerën prej 125.5 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 24.8 përqind.

Në vitin 2014, shërbimet kompjuterike, informative dhe të telekomunikacionit u karakterizuan me zvogëlim të bilancit në 19.5 milionë euro krahasuar me 32.1 milionë euro në vitin 2013. Bilanci i kësaj kategorie u zvogëlua kryesisht si pasojë e zvogëlimit të aktivitetit të kompanive të komunikimit në ekonominë e Kosovës, që mund të ketë rezultuar nga avancimi i vazhdueshëm i teknologjisë në kontekst të produkteve të reja që ofrohen pa pagesë. Gjithashtu, me bilanc më të ulët të shërbimeve u karakterizua kategoria e mallrave dhe shërbimeve qeveritare, që në vitin 2014 kishte vlerën prej 14.1 milionë euro (23.2 milionë euro në vitin 2013). Bilanci i shërbimeve të qeverisë u zvogëlua kryesisht si pasojë e zvogëlimit të vazhdueshëm të prezencës ndërkombëtare në Kosovë, përderisa në të njëjtën kohë pagesat për rezidentët kosovarë në misionet diplomatike jashtë vendit shënuan rritje.


Në kuadër të bilancit të shërbimeve, shërbimet e realizuara për procesim të mallrave arritën vlerën prej 3.8 milionë euro në vitin 2014, që paraqet një ngritje të lehtë krahasuar me vitin paraprak kur këto shërbime kishin vlerën prej 3.7 milionë euro.

Të ardhurat parësore

Llogaria e të ardhurave parësore në vitin 2014 kishte bilanc pozitiv prej 113.8 milionë euro, i cili është për 6.4 përqind më i ulët krahasuar me bilancin e vitit paraprak. Në vitin 2014, pranimet në kuadër të llogarisë së të ardhurave u zvogëluan në 215.8 milionë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 5.1 përqind. Në anën tjetër, pagesat u zvogëluan për 3.7 përqind, duke arritur vlerën prej 102.0 milionë euro.

Zvogëlimi i bilancit pozitiv në llogarinë e të ardhurave parësore ishte kryesisht pasojë e rritjes së pagesave dhe zvogëlimit të pranimeve në kuadër të llogarisë së kompensimit të punëtorëve (figura 44). Të ardhurat nga kompensimi i punëtorëve, që kryesisht përbëhen nga të ardhurat e punëtorëve sezonal jashtë vendit si dhe punëtorëve kosovarë në Afganistan dhe Irak, janë kategoria më e madhe në kuadër të pranimeve të llogarisë së të ardhurave primare. Në vitin 2014, të ardhurat nga kompensimi i punëtorëve arritën vlerën prej 206.5 milionë euro (223.2 milionë euro në vitin 2013). Në të njëjtën periudhë, pagesat për kompensimin e punëtorëve që përfshijnë punëtorët jorezidentë të angazhuar në Kosovë për periudhë më pak se një vit shënuan vlerën 6.1 milionë euro, krahasuar me 4.3 milionë euro sa ishin në vitin 2013.

Figura 44. Të ardhurat parësore, në milionë euro




Burimi: BQK (2015)

Të ardhurat nga investimet jashtë vendit kishin një bilanc negativ prej 85.9 milionë (97.4 milionë euro në vitin 2013). Pranimet në kuadër të të ardhurave nga investimet u rritën në 8.0 milionë euro në vitin 2014 (4.3 milionë euro në vitin 2013), përderisa pagesat zvogëluan vlerën në 93.9 milionë euro (101.6 milionë euro në vitin 2013). Pranimet në kuadër të llogarisë së të ardhurave nga investimet përbëhen kryesisht nga të ardhurat që janë realizuar nga investimet e institucioneve vendore në tregjet e jashtme, ndërkaq pagesat përbëhen kryesisht nga të ardhurat prej investimeve që i kanë realizuar kompanitë e huaja që veprojnë në Kosovë. Rritja e pranimeve nga investimet në periudhën raportuese kryesisht i atribuohet rritjes së të ardhurave nga investimet e BQK-së dhe bankave komerciale në tregjet e jashtme, të cilat kryesisht përbëhen nga investimet në letra me vlerë. Ndërkaq, rënia e pagesave në kuadër të të ardhurave nga investimet gjatë vitit 2014 kryesisht rezultoi nga rënia e pagesave në emër të interesit në investimet portfolio dhe investimeve tjera.

Të ardhurat dytësore

Në vitin 2014, llogaria e të ardhurave dytësore shënoi vlerën 1.2 miliard euro, që paraqet një rënie vjetore prej 4.1 përqind (figura 45). Struktura e të ardhurave dytësore vazhdon të dominohet nga transferet e sektorit privat (korporatat financiare, korporatave jofinanciare, ekonomive familjare, etj.), të cilat përfaqësuan 75.1 përqind e gjithsej të ardhurave dytësore, përderisa pjesa e mbetur prej 24.9 përqind është përbërë nga transferet qeveritare. Zvogëlimi i bilancit të të ardhurave dytësore gjatë vitit 2014 ishte pasojë e zvogëlimit të të hyrave në kuadër të transfereve qeveritare.

Figura 45. Të ardhurat dytësore, në milionë euro




Burimi: BQK (2015)

Bilanci i transfereve qeveritare (trasferet e donatorëve, EULEX-it dhe UNMIK-ut) u zvogëlua në 291.9 milionë euro krahasuar me 369.7 milionë euro sa ishte në vitin 2013, kryesisht si pasojë e zvogëlimit të donacioneve.

Remitencat, si kategori që dominojnë 71.0 përqind të gjithsej transfereve të sektorit privat u karakterizuan me rritje të konsiderueshme në vitin 2014. Remitencat e pranuar në Kosovë arritën vlerën prej 630.0 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 11.7 përqind (figura 46). Rrjedhimisht, remitencat si një ndër burimet më të qëndrueshme të financimit të konsumit të ekonomive familjare në Kosovë, përfaqësojnë kategori të rëndësishme që kontribuon në zvogëlimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse. Remitencat që pranohen në Kosovë vijnë kryesisht nga Gjermania dhe Zvicra, vende këto nga të cilat dërgohen 36.4 përkatësisht 22.5 përqind të gjithsej remitencave të pranuar në Kosovë. Një pjesë e

Figura 46. Pranimet e remitencave



Burimi: BQK (2015)

konsiderueshme e remitencave dërgohet edhe nga Italia dhe Austria, që kanë pjesëmarrje prej 5.0 përkatësisht 3.8 përqind në gjithsej remitencat e pranuar në Kosovë. Sa i përket kanaleve të transferimit të remitencave në vend, rreth 25.3 përqind e tyre transferohen përmes sistemit bankar, ndërkaq 39.3 përqind transferohen përmes agjensioneve për transferimin e parave. Pjesa e mbetur e dërgesave transforehen përmes kanaleve të tjera që përfshijnë edhe kanalet joformale. Në anën tjetër, dërgesat e jorezidentëve në Kosovë drejtë vendeve tjera shënuan vlerën prej 68.8 milionë euro në vitin 2014, që paraqet një rënie prej 9.1 përqind krahasuar me vitin paraprak.

7.2. Llogaria financiare

Llogaria financiare në vitin 2014 regjistroi bilanc negativ prej 145.1¹⁰ milionë euro krahasuar me bilancin negativ prej 132.2 milionë euro në vitin 2013. Asetet u rritën për vetëm 90.4 milionë euro, ndërkohë që në vitin 2013 patën shënuar rritje prej 217.2 milionë euro. Detyrimet u rritën për 235.4 milionë euro që është dukshëm më e ulët krahasuar me rritjen prej 349.4 milionë euro të shënuar në vitin paraprak. Në kuadër të aseteve kategoria kryesore ishin investimet tjera (kryesisht depozita) jashtë ekonomisë së Kosovës, ndërsa tek detyrimet kategoria kryesore vazhdon të jetë kategoria e investimeve të huaja direkte ndërsa (tabela 1).

Tabela 2. Llogaria financiare në milionë euro


Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014
LLOGARIA FINANCIARE	-275.8	-377.5	-141.0	-132.2	-145.1
<i>Asetet</i>	405.6	83.7	316.6	217.2	90.4
Investimet e huaja direkte (dalëse)	37.4	5.5	15.8	30.0	27.3
Investimet portfolio	48.6	57.8	185.7	139.3	13.3
Investimet tjera	266.2	81.7	-146.3	83.5	106.8
Asetet rezerve	53.4	-61.2	261.4	-35.7	-57.0
<i>Detyrimet</i>	681.4	461.2	457.6	349.4	235.4
Investimet e huaja direkte (hyrëse)	368.5	384.4	229.1	280.2	151.3
Investimet portfolio	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Investimet tjera	312.9	76.8	228.5	69.1	84.2

Burimi: BQK (2015)

Figura 47. Investimet e huaja direkte, në milionë euro

Investimet e Huaja Direkte

Bilanci i investimeve direkte i matur si diferencë ndërmjet IHD-ve në Kosovë dhe investimeve të rezidentëve kosovar në vendet tjera, në vitin 2014 ishte 123.8 milionë euro ose 50.5 përqind më e ulët sesa në vitin paraprak. Investimet e Huaja Direkte (IHD) të pranuar në Kosovë në vitin 2014 shënuan vlerën prej 151.2 milionë euro, apo pothuajse përgjysmë më pak se sa



Burimi: BQK (2015)


¹⁰ Bilanci negativ i llogarisë financiare nënkupton më shumë investime të realizuara në Kosovë nga jo-rezidentët krahasuar me investimet e rezidentëve kosovarë jashtë Kosovës.

në vitin 2013 (figura 47). Kjo vlerë dukshëm më e ulët e IHD-ve në vitin 2014 ishte rezultat i disa faktorëve. Përveç fluksit më të ulët të hyrjes së IHD-ve edhe shpërndarja e superdividendës¹¹, shitja e aksioneve të disa prej kompanive të huaja që operojnë në Kosovë të rezidentët kosovarë, si dhe kthimi më i lartë i kredive ndaj kompanive investuese kanë ndikuar në rënien e IHD-ve. Gjithashtu, investimet direkte të rezidentëve kosovarë në vende tjera ishin më të ulëta krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak dhe arritën vlerën prej 27.3 milionë euro (30.0 milionë euro në vitin 2013). Investimet direkte të rezidentëve kosovarë jashtë ekonomisë së Kosovës janë kryesisht investime kapitale, të cilat në të shumtën e rasteve janë blerje e patundshmëri.

IHD-të në Kosovë kryesisht janë përqendruar në sektorët e ekonomisë si patundshmëria me 142.1 milionë euro nga 151.2 milionë euro gjithsej IHD të realizuar në Kosovë gjatë vitit 2014, shërbimet financiare me 41.9 milionë euro, energjetika me 13.4 milionë euro, tregtia me 8.4 milionë euro. Siç edhe është paraqitur në figurën 48, viti 2014 u karakterizua me ndryshime për sa i përket strukturës së IHD-ve sipas sektorëve. Vlera e investimeve në patundshmëri ka shënuar rritje të vazhdueshme (4.5 përqind rritje në vitin 2014) ndërsa sektori financiar i cili në vitet paraprake vërehet se ka shënuar rënie, në vitin 2014 shënoi rritje të konsiderueshme. Gjatë vitit 2014 sektorët si industria, ndërtimi dhe transporti e komunikimi kanë pasur tërheqje të kapitalit kryesisht për shkak të blerjes së disa kompanive të huaja nga pronarët vendorë por edhe për shkak të shpërndarjes së superdividendës së disa prej kompanive të huaja.


Sa i përket formës së investimit, IHD-të e pranuar në Kosovë 77.1 përqind ishin në formë të kapitalit aksionar ndërsa pjesa tjetër (22.9 përqind) në instrumente të borxhit (kredi ndërmjet ndërmarrjeve). Siç edhe shihet në figurën 49 të dy këto kategori kanë shënuar rënie të konsiderueshme, mirëpo rënia ishte më e lartë tek instrumentet e borxhit. Konkretisht, investimet në kapital aksionar janë zvogëluar nga 176.0 milionë euro sa ishin në vitin 2013 në 116.6 milionë euro në vitin 2014, ndërsa kreditë ndërmjet ndërmarrjeve janë zvogëluar në vetëm 34.6 milionë euro nga 104.2 milionë euro sa ishin në vitin paraprak.

Figura 48. IHD-të sipas aktiviteteve kryesore ekonomike, në milionë euro



Burimi: BQK (2015)

Figura 49. Investimet e huaja direkte sipas formës së investimit, në milionë euro




Burimi: BQK (2015)

¹¹ Me superdividendë nënkuptohet dividendë e cila është më e lartë se sa fitimet e kompanisë në periudhën përkatëse. Shpërndarja e superdividendës ndikon në zvogëlimin e kapitalit aksionar, gjë e cila paraqet zvogëlim të IHD-ve.

Sa i përket origjinës së IHD-ve, Zvicra paraqet vendin prej nga kanë ardhur më së shumti IHD në vitin 2014 (38.2 milionë euro), pasuar nga Austria me 30.3 milionë euro, Gjermania me 29.4 milionë euro, Shqipëria me 20.4 milionë euro, Turqia me 20 milionë euro, etj. Përderisa investimet nga Austria dhe Gjermania ishin më të larta për 19.6 përkatësisht 7.8 milionë euro krahasuar me vitin paraprak, investimet nga Turqia dhe Zvicra ishin më të ulëta për 68.6 përkatësisht 3.5 milionë euro krahasuar me vitin paraprak.

Figura 50. IHD sipas shteteve kryesore, në milionë euro




Burimi: BQK (2015)

Investimet portfolio, investimet tjera dhe asetet rezervë

Investimet portfolio jashtë vendit në vitin 2014 arritën vlerën prej 13.3 milionë euro ndërkohë që në vitin paraprak patën shënuar vlerën prej 139.3 milionë euro. Pjesa më e madhe e investimeve portfolio përbëhet nga investimet e fondeve pensionale, ndërsa pjesa tjetër i takon Bankës Qendrore dhe bankave komerciale. Përderisa gjatë vitit 2013 kishte investimeve të konsiderueshme nga Banka Qendrore dhe bankat komerciale në letra me vlerë të borxhit, të cilat konsiderohen me shkallë të ulët të rrezikut, në vitin 2014 për shkak të perceptimeve për përmirësim të aktivitetit ekonomik në vendet e zhvilluara, rreth 294.9 milionë euro u zhvendosën nga investimet në letra me vlerë të borxhit dhe u investuan në letra me vlerë të kapitalit. Investimeve prej 294.9 milionë euro iu shtua edhe 13.3 milionë euro kapital shtesë të investuar në letra me vlerë të kapitalit.

Investimet tjera, të cilat përbëhen kryesisht prej depozitave dhe kredive, shënuan rritje të aseteve për 106.8 milionë euro. Kjo rritje e aseteve në kuadër të investimeve tjera i atribuohet rritjes së depozitave, të cilat në vitin 2014 u rritën për 157.4 milionë euro. Në anën tjetër, kreditë bankare ndaj jo-rezidentëve u zvogëluan për 50.6 milionë euro. Në kuadër të investimeve tjera, detyrimet shënuan rritje prej 84.2 milionë euro. Kjo rritje e detyrimeve ishte kryesisht për shkak të rritjes së detyrimeve në formë të kredive tregtare, të cilat shënuan rritje prej 37.9 milionë euro, por edhe detyrimeve në formë të depozitave të jo-rezidentëve në bankat komerciale në Kosovë të cilat shënuan rritje për 37.1 milionë euro. Siç është paraqitur në figurën 51, rritja e kredive tregtare ka korelacion mjaft të lartë me rritjen e nivelit të importeve.

Figura 51. Kreditë tregtare dhe importet, në milionë euro



Burimi: BQK (2015)

Asetet rezervë, të cilat janë të investuara kryesisht në instrumente të tregut të parasë dhe në depozita, në vitin 2014 janë zvogëluar për 57.0 milionë euro. Megjithatë, duke pasur parasysh faktin se në Kosovë përdoret Euro si valutë zyrtare, e cila është e pranueshme në çdo transaksion

ndërkombëtar, mund të konsiderohet se asetet rezervë në Kosovë nuk kanë rëndësi të madhe në krahasim me shumicën e vendeve tjera.


7.3. Pozicioni ndërkombëtar i investimeve

Pozicioni ndërkombëtar i investimeve (PNI)¹² neto në fund të vitit 2014 ishte pozitiv dhe kishte vlerën prej 297.3 milionë euro (figura 52). Bilanci pozitiv i PNI-së ka ndjekur trend rritës që nga vitit 2011, ku si përqindje e PBB-së nga 2.8 përqind sa ishte në vitin 2011 ka arritur në 5.4 përqind në vitin 2014.

Gjithsej asetet në fund të vitit 2014 arritën vlerën prej 4.3 miliardë euro (rritje vjetore prej 4.2 përqind). Rritjes së asetëve më së shumti i kanë kontribuar investimet tjera (kryesisht depozitat), të cilat shënuan rritje prej 6.0 përqind dhe investimet portfolio të cilat shënuan rritje prej 6.9 përqind. Investimet portfolio, të cilat kanë një pjesëmarrje të konsiderueshme në stokun e asetëve jashtë vendit (29.8 përqind), janë të investuara kryesisht në aksione në tregjet e kapitalit (80.4 përqind), ndërsa pjesa tjetër (19.6 përqind) në letra me vlerë të borxhit. Vlera e stokut të detyrimeve në fund të vitit 2014 arriti në 4.0 miliardë euro (6.4 përqind më shumë se viti 2013). Rritjes së detyrimeve më së shumti i ka kontribuar rritja e stokut të IHD-ve, gjë që paraqet një tipar të favorshëm struktural të detyrimeve pasi që IHD-të (përveç kredive ndërmjet kompanive) nuk hyjnë në kuadër të borxhit. IHD-të përbëjnë rreth 74.4 përqind të gjithsej detyrimeve ndërsa investimet tjera (kryesisht depozita dhe kredi) kanë një pjesëmarrje prej 25.6 përqind në gjithsej detyrimet.


Bilanci i investimeve portfolio dhe investimeve tjera shënoi rritje vjetore prej 6.9 përkatësisht 2.2 përqind në vitin 2014. Në anën tjetër, bilanci i investimeve direkte vazhdoi të jetë negativ (më shumë IHD janë investuar në Kosovë nga jo-rezidentët krahasuar me IHD-të që kanë bërë rezidentët kosovarë jashtë vendit) dhe shënoi rritje vjetore prej 4.4 përqind. Stoku i gjithsej IHD-ve të realizuara në Kosovë arriti vlerën prej 3.0 miliardë euro në fund të vitit 2014 që është për 5.1 përqind më i lartë se sa stoku i IHD-ve në fund të vitit 2013. Rritje ka shënuar edhe stoku i investimeve direkte të realizuara jashtë ekonomisë së Kosovës nga rezidentët kosovarë, të cilat regjistruan një rritje vjetore prej 18.4 përqind dhe arritën vlerën prej 174.6 milionë euro.

Figura 52. Pozicioni ndërkombëtar i investimeve, në miliardë euro



Burimi: BQK (2015)

Figura 53. Pozicioni ndërkombëtar i investimeve neto sipas sektorëve institucional, në miliardë euro



Burimi: BQK (2015)

¹² PNI paraqet gjendjen në fund të një periudhe të caktuar kohore të asetëve dhe detyrimeve të jashtme financiare. Gjendja në fund të periudhës është rezultat i gjithë transaksioneve që rrjedhin nga e kaluara, përfshirë edhe korrigjimet si pasojë e lëvizjeve në kursin e këmbimit për të llogaritur vlerën e mjeteve/detyrimeve financiare në ditën e raportimit apo ndryshimet në çmimin e tregut. Bilanci pozitiv i PNI-së nënkupton se shuma e mjeteve të investuara nga Kosova jashtë vendit është më e madhe se sa shuma e mjeteve të investuara nga shtetet tjera në Kosovë.


Sa i përket sektorëve institucional, Banka Qendrore dhe bankat komerciale kanë pasur në vazhdimësi bilanc pozitiv të pozicionit të investimeve ndërkomëtare (1.2 miliardë përkatësisht 481.6 milionë euro në fund të vitit 2014), ndërsa sektorët tjerë¹³ dhe qeveria në vazhdimësi kanë pasur bilanc negativ (1.1 miliardë përkatësisht 326.4 milionë euro) (figura 53).

7.4. Borxhi i jashtëm

Borxhi i jashtëm i Kosovës, i cili përfshinë borxhin e jashtëm privat dhe borxhin e jashtëm publik¹⁴, në fund të vitit 2014 arriti në 1.7 miliardë euro që është për 8.0 përqind më i lartë se sa në fund të vitit 2013. Si përqindje e PBB-së, borxhi i jashtëm bruto arriti në 31.7 përqind (figura 54). Borxhi i jashtëm publik ka një pjesëmarrje të ulët në gjithsej borxhin e jashtëm bruto, çka reflekton nivelin e ulët të borxhit të përgjithshëm publik në Kosovë krahasuar me vendet tjera të rajonit. Borxhi i jashtëm publik në fund të vitit 2014 kishte vlerën prej 392.8 milionë euro apo 22.6 përqind e borxhit të jashtëm bruto.


Pjesa më e madhe e borxhit të jashtëm përbëhet nga huatë ndërmjet kompanive (figura 55). Kompanitë e huaja që operojnë në Kosovë i detyrohen sektorit të jashtëm me 720.0 milionë euro apo 41.4 përqind të gjithsej borxhit të jashtëm. Me pjesëmarrje të konsiderueshme në gjithsej borxhin e jashtëm të Kosovës janë edhe sektorët tjerë (390.1 milionë euro ose 22.5 përqind e gjithsej borxhit të jashtëm). Borxhi i jashtëm i qeverisë në vlerë prej 326.4 milionë euro është kryesisht borxh i trashëguar që nënkuptohet se është borxh afatgjatë dhe përbën 18.8 përqind të gjithsej borxhit të jashtëm bruto. Rreth 57.1 përqind e gjithsej borxhit publik parashihet të paguhet në një periudhë afatgjate (mbi 5 vite), 35.2 përqind në një periudhë afatmesme (1 deri në 5 vite) dhe vetëm 7.7 përqind në një periudhë afatshkurtër (nën një vit). Stoku i borxhit të jashtëm bruto i sistemit bankar në fund të vitit 2014 ishte 234.2 milionë euro ose 13.5 përqind e gjithsej borxhit të jashtëm. Ky borxh është afatshkurtër dhe pjesën më të madhe të tij e përbëjnë depozitat e jo-rezidentëve. Me pjesëmarrjen më të ulët në gjithsej borxhin e jashtëm është Banka Qendrore (66.3 milionë euro apo 3.8 përqind e gjithsej borxhit të jashtëm). Detyrimet e Bankës Qendrore i përkasin kryesisht alokimeve të Drejtave Speciale të Tërheqjes (angl. Special Drawing Rights: SDR) nga FMN-ja.

Figura 54. Borxhi i jashtëm bruto, në milionë euro



Burimi: BQK (2015)

Figura 55. Borxhi i jashtëm bruto sipas sektorëve, në milionë euro



Burimi: BQK (2015)

¹³ Në kuadër të sektorëve tjerë përfshihen: fondet pensionale, ndihmësit financiarë, kompanitë e sigurimeve, organizatat joqeveritare, kompanitë private dhe individët.

¹⁴ Në kuadër të borxhit publik përfshihet borxhi i qeverisë dhe bankës qendrore, ndërsa në kuadër të borxhit privat përfshihen huatë ndërmjet kompanive, sistemin bankar dhe sektorët tjerë.

Sa i përket kreditorëve, gjithsej borxhi i jashtëm prej 1.7 miliardë euro iu përket FMN-së me 10.2 përqind, Bankës Botërore me 12.1 përqind dhe kreditorëve tjerë (më shumë se gjysma e borxhit ndaj kreditorëve tjerë është kreditim ndërmjet kompanive) me 77.7 përqind.

Borxhi i sektorit të jashtëm ndaj ekonomisë së Kosovës në fund të vitit 2014 arriti në 3.1 miliardë euro. Këto mjete kryesisht janë fonde të investuara jashtë vendit si mjetet e privatizimit dhe të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, të cilat kryesisht janë të investuara në formë të depozitave me 84.8 përqind, pasuar nga mjetet e investuara në letra me vlerë të borxhit 10.3 përqind dhe kreditë të cilat kanë një pjesëmarrje prej 2.4 përqind.

8. Parashikimet makroekonomike për vitin 2015

8.1. Produkti i brendshëm bruto

Ekonomia e Kosovës pritet të përshpejtojë ritmin e rritjes gjatë vitit 2015. Norma e rritjes së PBB-së reale, sipas BQK-së, pritet të jetë 3.5 përqind. Kjo rritje pritet të gjenerohet nga kërkesa e brendshme, ndërsa neto eksportet parashihet të vazhdojnë të kenë kontribut negativ në rritjen e PBB-së (figura 56).

Konsumi, si komponenta kryesore e kërkesës së brendshme, pritet që edhe gjatë vitit 2015 të ketë kontributin kryesor në rritjen ekonomike por me një shkallë më të vogël të kontributit se sa në vitin paraprak (figura 57). Rritja e konsumit të përgjithshëm pritet të jetë 2.8 përqind, bazuar në pritjet që konsumi privat do të rritet me 2.5 përqind dhe konsumi publik do të rritet me 4.7 përqind. Faktorët kryesorë që pritet të ndikojnë në rritjen e konsumit gjatë kësaj periudhe janë rritja e pagave për shërbyesit civil (rritja e pagave në prill të vitit 2014 pritet të ketë ndikim edhe në vitin 2015 pasi që efekti është i plotë për tërë vitin), rritja e remitencave si dhe rritja e kredive konsumuese.

Është inkurajues fakti i rritjes së remitencave të cilat deri në maj 2015 shënuan rritje prej 18.7 përqind. Gjithashtu edhe kreditë e reja konsumuese deri në qershor 2015 shënuan rritje prej 9.8 përqind. Megjithatë, për shkak të parashikimit për rritje më të shpejtë të investimeve, përkundër rritjes së konsumit me 2.8 përqind, pjesëmarrja e konsumit në PBB nga 107.5 përqind sa ishte në vitin paraprak pritet të zvogëlohet në 106.8 përqind.

Investimet në vitin 2015 parashihet të shënojnë rritje ndërkohë që në vitin e kaluar vlerësohet të kenë shënuar rënie. Gjatë vitit 2015, investimet pritet të karakterizohen me rritje reale prej 6.5 përqind dhe të kontribuojnë në rritjen e PBB-së me 1.6 pikë përqindje. Investimet private, të cilat përbëjnë rreth 69.0 përqind të gjithsej investimeve, pritet të shënojnë rritje reale prej 4.5 përqind. Në të njëjtën periudhë, investimet publike, të cilat kanë një pjesëmarrje prej 31.0 përqind në gjithsej investimet, pritet të shënojnë rritje prej 11.3 përqind. Rritja e investimeve publike, përveç projekteve të reja, pritet të jetë edhe për shkak të realizimit të projekteve të cilat ishin planifikuar por nuk u realizuan në vitin paraprak. Gjithashtu, projektet me rëndësi të veçantë, siç është koncesionimi i kompleksit turistik “Brezovica”, vazhdimi i punimeve në Autostradën Prishtinë-Shkup, pritet të ndikojnë në rritjen e investimeve private. Investimet private pritet të nxiten edhe si rezultat i aktivitetit kreditor, i cili pritet të përshpejtohet për shkak të rënies së normave të interesit në kredi si dhe lehtësimit të standardeve për aprovimin e

Figura 56. Rritja reale e PBB-së, kërkesa e brendshme dhe e jashtme, në përqindje





Figura 57. Rritja reale e PBB-së dhe kontribuesit në rritje, në përqindje



kredive nga ana e bankave. Edhe IHD-të, të cilat deri në maj 2015 arritën në 157.7 milionë euro nga 29.1 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit paraprak, pritet të kontribuojnë në rritjen e investimeve. Si rezultat i përshpejtimit të rritjes së investimeve, pritet që të shtohet edhe pjesëmarrja e tyre në gjithsej PBB-në nga 24.9 përqind sa ishte në vitin 2014 në 25.6 përqind në vitin 2015.


Neto eksportet e mallrave dhe shërbimeve në vitin 2015 pritet të kontribuojnë negativisht në rritjen e PBB-së me 1.1 pikë përqindje. Ky ndikim negativ i neto eksporteve i atribuohet rritjes së kërkesës së brendshme e cila pritet të ndikojë në rritjen e importit. Në kuadër të mallrave, parashikimet aktuale janë se eksportet do të rriten me rreth 14.3 përqind në terma real, ndërsa importet me rreth 4.9 përqind. Niveli më i lartë i importit të mallrave krahasuar me eksportin do të ndikojë që deficitin tregtar të mallrave në terma real të thellohet për 3.5 përqind. Në anën tjetër, pozicioni tregtar në kuadër të shërbimeve pritet të jetë pozitiv edhe gjatë vitit 2015 dhe të shënojë rritje për 3.0 përqind.

8.2. Sektori fiskal

Në vitin 2015, të hyrat buxhetore sipas parashikimeve të BQK-së pritet të rriten me 6.5 përqind, ndërsa shpenzimet buxhetore pritet të shënojnë rritje prej 7.5 përqind (figura 58). Të hyrat primare gjatë vitit 2015 pritet të arrijnë në 1.4 miliardë euro apo 6.5 përqind më shumë se sa në vitin paraprak. Në raport me PBB-në, të hyrat buxhetore pritet të kenë një ngritje të lehtë nga 24.4 përqind sa ishin në vitin e kaluar në 25.0 përqind në vitin 2015. Kjo rritje e të hyrave buxhetore pritet të jetë rezultat i rritjes së aktivitetit ekonomik, por edhe vazhdimit të luftimit të ekonomisë joformale. Të hyrat nga tatimet kufitare parashikohet të arrijnë në rreth 909.9 milionë euro apo 5.9 përqind krahasuar me vitin e kaluar, ndërsa të hyrat nga tatimet vendore pritet të arrijnë në 336.2 milionë euro apo 6.9 përqind më shumë krahasuar me vitin e kaluar.

Shpenzimet primare buxhetore gjatë vitit 2015 pritet të arrijnë në 1.6 miliardë euro apo 7.5 përqind më shumë se sa në vitin paraprak. Si përqindje e PBB-së, shpenzimet buxhetore pritet të rriten nga 26.7 përqind sa ishin në vitin 2014 në 27.7 përqind në vitin 2015. Shpenzimet rrjedhëse parashihet të zvogëlojnë pjesëmarrjen në gjithsej shpenzimet nga 71.8 përqind sa ishte në vitin 2014 në 70.9 përqind në vitin 2015. Pagat e mëditjet si dhe subvencionet e transferet pritet të rriten me nga 11.4 përkatësisht 5.0 përqind, ndërsa mallrat dhe shërbimet pritet të shënojnë rënie për 4.5 përqind. Në anën tjetër, shpenzimet kapitale të cilat parashikohet të shënojnë rritje për 11.3 përqind, pritet të rrisin pjesëmarrjen në gjithsej shpenzimet nga 27.4 përqind sa ishte në vitin 2014 në 28.4 përqind në vitin 2015.

Figura 58. Të hyrat dhe shpenzimet primare buxhetore, në milionë euro



p- parashikim
Burimi: MF (2013) dhe BQK për vitet 2014-2015

8.3. Sektori bankar

Në vitin 2015 parashikohet që norma vjetore e rritjes së kreditimit ndaj sektorit privat të jetë 5.2 përqind, që është e ngjashme me vitin e kaluar (figura 59). Përveç lehtësimit të standardeve të kreditimit nga bankat, si dhe rritjes së kërkesës së përgjithshme në vend, faktorë tjetër me rëndësi që pritet të ndikojnë në rritjen e mëtejme të kreditimit është edhe rënia e normave të interesit në kredi të cilat pritet të nxisin rritjen e kërkesës për kredi. Parashikimet e BQK-së për rritje të kreditimit janë gjithashtu në linjë me raportimet e bankave në kuadër të anketës së kreditimit bankar, rezultatet nga e cila sugjerojnë se do të ketë përsheptim të aktivitetit kreditor gjatë periudhave në vazhdim.

Depozitat e sektorit privat gjatë vitit 2015 pritet të vazhdojnë trendin e rritjes që i ka karakterizuar në vitet e fundit. Rritja e depozitave të sektorit privat gjatë vitit 2015 pritet të jetë rreth 4.7 përqind krahasuar me 4.0 përqind në vitin 2014 (figura 60). Rrjedha e pritur e depozitave është e lidhur me të ardhurat kombëtare të disponueshme të cilat pritet të rriten për 4.2 përqind në vitin 2015.

8.4. Sektori i jashtëm

Në vitin 2015, sektori i jashtëm pritet të karakterizohet me nivel pothuajse të ngjashëm të deficitit të llogarisë rrjedhëse dhe kapitale krahasuar me vitin 2014 (figura 61). Vlera e deficitit të llogarisë rrjedhëse dhe kapitale parashikohet të jetë 419.3 milionë euro (419.8 milionë euro deficit në vitin e kaluar). Gjithashtu, bilanci i llogarisë financiare i cili pritet të jetë -144.6 milionë euro është pothuajse i njëjtë me vitin e kaluar (-145.1 milionë euro). Deficiti i llogarisë rrjedhëse dhe kapitale pritet të jetë ekuivalent me 7.3 përqind të PBB-së në vitin 2015, që paraqet nivel më të ulët krahasuar me vitin paraprak kur deficitin në llogarinë rrjedhëse dhe kapitale ishte 7.6 përqind e PBB-së.

Figura 59. Depozitat e sektorit privat dhe PBB-ja reale




Figura 60. Kreditimi ndaj sektorit privat dhe PBB-ja reale





Figura 61. Llogaria rrjedhëse, në milionë euro



Në vitin 2015, eksporti i mallrave pritet të arrijë në 359.2 milion euro, që paraqet një rritje nominale vjetore prej 12.0 përqind krahasuar me vitin paraprak. Parashikimet për rritjen e eksporteve në vitin 2015 kryesisht bazohen në pritjet për përshejtimin e aktivitetit në disa nga sektorët e ekonomisë si bujqësia dhe prodhimi por edhe parashikimeve për rritje të kërkesës së jashtme.

Importi i mallrave pritet të shënojë vlerën 2.5 miliardë euro në vitin 2015 që paraqet rritje nominale vjetore prej 4.1 përqind (figura 62). Rritja e vlerës së gjithsej importit pritet të nxitet kryesisht nga rritja e kërkesës së përgjithshme në vend gjatë vitit 2015.


Deficitit i mallrave dhe shërbimeve pritet të rritet për 2.5 përqind që i atribuohet rritjes së deficitit të mallrave prej 2.9 përqind, ndërkohë që suficiti i shërbimeve pritet të shënojë rritje prej 4.5 përqind dhe të arrijë në 351.3

milionë euro. Në vitin 2015, importi dhe eksporti i shërbimeve pritet të shënojnë rritje prej rreth 4.0 përqind secila, ku pesha më e madhe që ka eksporti në gjithsej tregtinë e shërbimeve pritet të ndikojë në rritje të suficitit të llogarisë së shërbimeve. Importi i shërbimeve pritet të arrijë në 451.6 milionë euro në vitin 2015, ndërsa eksporti i shërbimeve pritet të arrijë në 802.9 milion euro. Rritja e importit të shërbimeve gjatë vitit 2015 pritet të gjenerohet kryesisht nga rritja e importit të shërbimeve të udhëtimit, transportit dhe shërbimeve ndërtimore. Ndërkaq, rritja e shërbimeve të eksportit gjatë vitit 2015 pritet të gjenerohet nga rritja e eksportit të shërbimeve të udhëtimit që kryesisht paraqet shpenzimet e emigrantëve gjatë qëndrimit në Kosovë. Bilanci i mallrave dhe shërbimeve pritet të shënojë deficit tregtar prej 1.8 miliardë euro në vitin 2015, që paraqet një rritje vjetore prej 2.5 përqind.

Bilanci i llogarisë së të ardhurave dytësore në vitin 2015 pritet të shënojë suficit prej 1.2 miliardë euro që është për 3.7 përqind më shumë se sa suficiti i shënuar në vitin paraprak. Kjo rritje e suficitit i atribuohet kryesisht parashikimeve për rritje të remitencave për 11.5 përqind. Në anën tjetër, transferet qeveritare pritet të shënojnë rënie prej 9.3 përqind.

Bilanci i llogarisë financiare pritet të arrijë nivelin prej -144.6 milionë euro apo 0.3 përqind më pak se bilanci i kësaj llogarie në vitin paraprak. IHD-të pritet të mbesin komponenta kryesore e llogarisë financiare e cila për vitin 2015 është parashikuar të karakterizohet me një rritje prej 61.2 përqind. Rritja e IHD-ve pritet të jetë kryesisht për shkak të realizimit të projekteve me rëndësi të veçantë, siç është koncesionimi i kompleksit turistik “Brezovica” dhe vazhdimin të punimeve në autostradën Prishtinë-Shkup.

Figura 62. Eksorti dhe importi i mallrave, në milionë euro



9. Shtojca statistikore

Tabela 1. Treguesit kryesor makroekonomik

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014 (v)	2015 (p)
	<i>Në milionë euro (vlera nominale)</i>					
Produkti i Brendshëm Bruto (PBB)/1	4,401.9	4,814.6	5,058.8	5,326.6	5,517.7	5,720.2
Konsumi	4,516.5	4,975.5	5,320.4	5,539.4	5,901.8	6,069.7
Investimet	1,450.6	1,632.4	1,465.1	1,470.9	1,331.3	1,409.4
Neto Eksportet	-1,565.2	-1,793.3	-1,726.7	-1,683.7	-1,715.4	-1,759.0
	<i>Ndryshimi në përqindje, në terma real</i>					
Rritja reale e PBB-së/1	3.3	4.4	2.8	3.4	2.7	3.5
Konsumi	2.5	3.0	2.6	2.2	6.1	2.8
Investimet	10.9	7.9	-12.9	-0.3	-7.6	6.5
Neto Eksportet	7.5	3.7	-12.1	-3.6	5.0	3.5
	<i>Në milionë euro (vlera nominale)</i>					
Llogaria Rrjedhëse/2	-515.7	-658.4	-380.2	-339.4	-441.0	-440.5
Importi i Mallrave	-2,040.8	-2,363.7	-2,332.0	-2,287.0	-2,372.3	-2,469.4
Eksporti i Mallrave	299.2	316.5	281.9	291.5	320.8	359.2
Importi i Shërbimeve	-397.8	-368.9	-317.2	-320.3	-434.5	-451.6
Eksporti i Shërbimeve	574.3	625.2	641.0	632.5	770.6	802.9
Remitencat/2	584.3	584.8	605.1	620.8	693.8	773.4
	<i>Në milionë euro (vlera nominale)</i>					
Gjithsej kreditë e sektorit bankar për sektorin privat/2	1,450.8	1,664.1	1,739.5	1,785.7	1,881.3	1,979.6
Gjithsej depozitat e sektorit privat në sektorin bankar/2	1,713.8	1,908.5	2,115.8	2,285.9	2,377.9	2,490.2
	<i>Në milionë euro (vlera nominale)</i>					
Buxheti i Kosovës/3						
Gjithsej të hyrat primare dhe grantet	1,166.0	1,309.2	1,321.7	1,328.7	1,343.7	1,430.5
Gjithsej shpenzimet primare	1,264.7	1,382.2	1,441.0	1,480.8	1,475.1	1,585.0
Deficiti primar	-98.7	-73.0	-119.3	-152.1	-131.4	-154.5
	<i>Ndryshimi në përqindje</i>					
Rritja ekonomike reale/4						
Globale	5.4	4.1	3.4	3.3	3.3	3.8
Eurozona	1.9	1.6	-0.7	-0.4	0.8	1.3
Vendet në zhvillim të Evropës	4.7	5.5	1.4	2.8	2.7	2.9

1/ Agjensia Statistikore e Kosovës për vitet 2010-2013

2/ Banka Qendrore e Republikës së Kosovës për vitet 2010-2013

3/ Ministria e Financave për vitet 2010-2013

4/ Fondi Monetar Ndërkombëtar për vitet 2010-2015

(v) Vlerësim

(p) Parashikim

Pjesët e hijezuara paraqesin vlerësime dhe parashikime të BQK-së

Tabela 2.1. Bilanci i pagesave, komponentët kryesorë

(Në milionë euro)

Përshkrimi	Bilanci nga llogaria rrjedhese dhe kapitale							Bilanci nga llogaria financiare					Gabimet dhe harresat
	Llogaria rrjedhese						Llogaria kapitale	Investimet direkte	Investimet portofolio	Investimet tjera	Asetet rezervë		
	Mallrat	Shërbimet	Të ardhurat parësore	Të ardhurat dytësore									
2005	-228.7	-247.6	-1078.5	-8.5	139.1	700.3	18.9	53.8	107.6	-17.5	-68.7	32.4	174.8
2006	-205.2	-226.1	-1173.1	29.0	158.8	759.2	20.8	-35.7	289.2	-65.4	-181.7	-77.9	240.9
2007	-197.5	-214.0	-1354.4	12.0	186.3	842.0	16.5	5.8	-431.0	34.5	108.0	294.3	203.3
2008	-450.5	-460.9	-1644.7	146.6	164.0	873.2	10.5	-288.4	-341.5	109.9	-75.1	18.2	162.1
2009	-273.9	-374.2	-1646.3	227.8	60.9	983.4	100.3	-113.1	-280.9	124.8	137.8	-94.8	160.9
2010	-494.4	-515.7	-1741.6	176.4	67.0	982.5	21.3	-275.8	-331.1	48.6	-46.7	53.4	218.5
2011	-616.4	-658.4	-2047.1	256.3	111.3	1021.1	42.0	-377.5	-378.9	57.8	4.8	-61.2	238.9
2012	-367.2	-380.2	-2050.1	323.8	153.6	1192.5	12.9	-141.0	-213.3	185.7	-374.9	261.4	226.2
2013	-304.7	-339.4	-1995.6	312.2	121.5	1222.4	34.7	-132.2	-250.2	139.3	14.4	-35.7	172.5
2014	-415.8	-437.0	-2058.6	335.9	113.8	1171.9	21.2	-145.0	-23.8	13.3	22.6	-57.0	270.8
T1	-53.3	-57.9	-311.3	34.3	23.8	195.3	4.7	-10.0	-61.0	18.3	24.3	8.5	43.3
T2	-133.8	-137.5	-440.4	55.5	18.8	228.6	3.7	-142.3	-42.9	6.5	-147.3	41.5	-8.5
T3	-184.8	-191.7	-511.9	58.9	1.1	260.2	6.9	0.5	-111.4	-1.9	-28.9	142.6	185.3
2010 T4	-122.5	-128.5	-478.0	27.3	23.8	298.4	6.0	-124.0	-115.8	25.7	105.3	-139.2	-1.5
T1	-25.2	-38.5	-380.0	72.3	41.3	227.9	13.3	3.8	-81.7	53.1	-28.6	60.9	29.0
T2	-158.5	-164.5	-511.4	66.7	28.4	251.7	6.0	-210.7	-98.6	49.7	-133.5	-28.2	-52.2
T3	-190.4	-196.7	-554.4	60.0	21.2	276.4	6.3	23.8	-105.8	8.8	18.1	2.6	24.2
2011 T4	-242.3	-258.7	-601.5	57.2	20.4	265.1	16.4	-194.4	-92.9	-53.8	48.9	-96.5	47.9
T1	-21.8	-20.9	-369.4	43.8	37.4	267.2	-0.9	-13.8	-55.0	81.0	-47.8	8.0	8.0
T2	-118.4	-120.9	-543.0	75.9	43.9	302.3	2.5	-86.4	-23.5	-37.0	-36.9	11.1	32.0
T3	-145.2	-143.5	-605.5	122.8	20.3	318.9	-1.7	25.9	-88.5	163.2	-255.0	206.2	171.1
2012 T4	-81.8	-94.9	-532.2	81.3	51.9	304.1	13.0	-66.7	-46.3	-21.5	-35.1	36.2	15.1
T1	-2.8	-13.4	-390.7	60.6	42.4	274.3	10.6	10.1	-57.3	53.5	20.1	-6.3	12.9
T2	-114.3	-117.5	-518.6	79.7	32.5	288.9	3.1	-138.1	-83.8	81.7	-150.6	14.6	-23.8
T3	-90.1	-99.7	-551.9	124.1	2.1	326.0	9.7	58.1	-56.8	91.8	-46.2	69.3	148.1
2013 T4	-97.5	-108.8	-534.3	47.8	44.6	333.2	11.4	-62.2	-52.4	-87.7	191.1	-113.3	35.3
T1	-34.2	-37.6	-391.9	63.3	31.4	259.7	3.4	33.4	-37.5	50.2	26.8	-6.2	67.6
T2	-158.4	-155.8	-538.5	75.1	31.4	276.1	-2.6	-115.8	-0.2	3.2	-97.1	-21.7	42.6
T3	-83.8	-88.4	-582.7	138.0	23.5	332.9	4.6	44.8	-67.2	59.3	1.1	51.7	128.6
2014 T4	-139.4	-155.2	-545.5	59.5	27.5	303.3	15.8	-107.4	-19.0	-99.4	91.8	-80.8	32.0
Janar	7.0	8.6	-100.4	26.2	11.8	71.0	-1.6	65.5	-17.3	37.4	-34.4	79.8	58.5
Shkurt	-25.3	-24.6	-125.6	14.5	13.1	73.4	-0.7	-21.0	-13.1	-4.5	52.2	-55.6	4.3
Mars	-15.9	-21.6	-165.9	22.5	6.5	115.3	5.7	-11.1	-7.1	17.3	9.0	-30.4	4.8
Prill	-27.4	-27.0	-169.6	32.5	13.3	96.8	-0.5	-23.2	22.8	15.4	-40.0	-21.3	4.3
Maj	-74.7	-73.5	-191.8	26.2	9.2	83.0	-1.2	-58.4	-15.2	-7.5	7.0	-42.7	16.3
Qershor	-56.3	-55.3	-177.0	16.3	9.0	96.4	-0.9	-34.3	-7.7	-4.7	-64.1	42.2	22.0
Korrik	-10.6	-11.9	-187.7	65.0	11.1	99.7	1.3	3.2	-22.0	2.4	33.9	-11.1	13.8
Gusht	-15.1	-14.4	-193.3	47.7	7.3	124.0	-0.8	67.3	-21.6	9.6	17.9	61.4	82.5
Shtator	-58.0	-62.1	-201.7	25.3	5.1	109.1	4.1	-25.7	-23.6	47.3	-50.7	1.3	32.3
Tetor	-47.6	-50.1	-191.5	21.2	13.1	107.1	2.5	-9.3	-14.7	-36.4	38.0	3.7	38.3
Nëntor	-69.9	-68.8	-169.0	21.9	4.9	73.5	-1.1	-44.7	-16.1	15.2	-53.3	9.5	25.2
2014 Dhjetor	-21.9	-36.4	-185.0	16.4	9.5	122.7	14.4	-53.4	11.8	-78.1	107.0	-94.0	-31.4

Burimi: BQK (2015)

Tabela 2.2. Mallrat

(Në milionë euro)

Përshkrimi	Gjithësj mallrat									
	Mallra të përgjithshme mbi bazën e bilancit të pagesave					Eksporti neto i mallrave në tregtinë transit			Arijmonetar	
		Kredi	Debi	prej të cilave rieksporte (kredit)		Mallrat e blera nga tregtia transit (eksportet negative)	Mallrat e shitura si nënkategori e tregtisë së mallrave (kredit)		Kredi	Debi
2007	-1354.4	-1354.4	164.1	1518.5	13
2008	-1644.7	-1644.7	211.3	1856.0	16
2009	-1646.3	-1646.3	172.5	1818.8	13
T1	-311.3	-311.3	54.0	365.3	0.3
T2	-751.7	-751.7	144.4	896.1	10
T3	-1263.6	-1263.6	218.8	1482.4	17
2010 T4	-1741.6	-1741.6	299.2	2040.8	2.3
T1	-380.0	-380.0	74.9	454.9	0.5
T2	-891.3	-891.3	165.1	1056.5	12
T3	-1445.7	-1445.7	244.4	1690.1	19
2011 T4	-2047.1	-2047.1	316.5	2363.7	2.4
T1	-369.4	-369.4	60.4	429.7	0.4
T2	-912.4	-912.4	137.6	1049.9	0.9
T3	-1517.9	-1517.9	208.5	1726.4	16
2012 T4	-2050.1	-2050.1	281.9	2332.0	2.1
T1	-390.7	-390.7	68.5	459.2	0.5
T2	-909.3	-909.3	149.3	1058.6	10
T3	-1461.2	-1461.2	221.3	1682.5	17
2013 T4	-1995.6	-1995.6	291.5	2287.0	2.2
T1	-391.9	-391.9	66.1	458.0	0.4
T2	-930.4	-930.4	141.5	1071.9	11
T3	-1513.1	-1513.1	238.3	1751.5	3.0
2014 T4	-2058.6	-2058.6	324.3	2382.9	4.7
Janar	-100.4	-100.4	20.7	121.1	0.1
Shkurt	-226.0	-226.0	43.0	269.0	0.3
Mars	-391.9	-391.9	66.1	458.0	0.4
Prill	-561.5	-561.5	90.7	652.2	0.6
Maj	-753.4	-753.4	114.5	867.9	0.7
Qershor	-930.4	-930.4	141.5	1071.9	11
Korrik	-1118.1	-1118.1	176.5	1294.6	16
Gusht	-1311.5	-1311.5	209.8	1521.2	2.3
Shtator	-1513.1	-1513.1	238.3	1751.5	3.0
Tetor	-1704.6	-1704.6	267.5	1972.1	3.3
Nëntor	-1873.6	-1873.6	297.7	2171.3	4.0
2014 Dhjetor	-2058.6	-2058.6	324.3	2382.9	4.7

Burimi: BQK (2015)

Tabela 2.3. Shërbimet, neto

(Në milionë euro)

Përshkrimi	Balanci												
		Shërbimet e prodhimit mbiturimet fizike në pronësi të tjerëve	Shërbimet e mirëmbajtjes dhe riparimit	Transporti	Udhëtimi	Ndërtimi	Shërbimet pensionale dhe të sigurimit	Shërbimet financiare	Tarifat për përdorimin e pronësisë intelektuale j.p.l	Shërbimet kompjuterike, informative dhe të telekomunikacionit	Shërbimet tjera të biznesit	Shërbimet personale, kulturore dhe rekreative	Mallrat dhe shërbimet qeveritare
2007	112.0	3.6	-2.1	-19.2	96.6	-17.3	-8.7	-4.4	-1.7	39.3	-55.3	...	812
2008	146.6	1.6	-6.5	-40.0	125.0	3.2	-12.1	0.1	-3.2	36.9	-46.0	...	87.6
2009	227.8	3.7	-9.1	-39.1	195.9	10.7	-9.6	3.5	-3.0	56.8	-61.7	...	79.7
2010	176.4	2.9	-13.4	-44.1	223.0	-20.2	-12.8	3.2	-2.1	45.4	-61.8	...	56.4
2011	256.3	5.2	-17.1	-53.4	235.0	-5.3	-17.1	-0.8	-0.4	76.8	-18.1	...	51.6
2012	323.8	3.5	-25.7	-50.7	309.9	11.0	-4.0	-1.3	-0.2	47.4	3.1	...	30.9
2013	312.2	3.7	-0.2	-51.4	304.2	6.5	-9.4	-0.7	-1.9	32.1	6.0	...	23.2
2014	335.9	3.8	-2.5	-73.0	378.8	4.4	-14.1	-2.2	-1.9	19.5	8.2	10	14.1
T1	34.3	0.5	-2.9	-8.1	41.4	-1.9	-3.3	0.2	-1.7	11.8	-17.1	...	15.4
T2	55.5	0.7	-3.4	-9.4	49.5	0.0	-3.8	0.0	-0.6	12.8	-6.8	...	16.6
T3	58.9	1.0	-3.8	-13.1	75.5	-10.2	-0.4	2.2	0.2	11.4	-16.9	...	13.1
2010 T4	27.3	0.7	-3.4	-13.4	56.7	-8.0	-5.3	0.8	...	9.5	-21.4	...	11.2
T1	72.3	1.4	-3.5	-9.4	53.2	-3.1	-3.8	-0.3	-0.1	22.9	1.6	...	13.4
T2	66.7	1.4	-4.2	-14.7	64.7	-3.8	-5.9	0.0	-0.1	18.0	-1.8	...	13.1
T3	60.0	1.3	-4.3	-15.1	58.1	2.7	-2.5	-0.3	-0.1	18.5	-11.0	...	12.6
2011 T4	57.2	1.0	-5.1	-14.3	59.0	-1.2	-5.0	-0.2	-0.1	17.4	-6.9	...	12.5
T1	43.8	0.7	-4.3	-8.7	42.0	-2.8	-5.1	-0.1	-0.2	11.4	2.5	...	8.2
T2	75.9	0.9	-6.7	-15.1	68.5	3.6	-4.1	-0.2	0.0	11.2	8.9	...	8.9
T3	122.8	1.0	-6.9	-16.7	126.9	6.4	-2.4	-0.5	0.0	13.5	-5.6	...	7.3
2012 T4	81.3	0.9	-7.8	-10.2	72.9	3.8	7.6	-0.5	0.0	11.3	-3.1	...	6.4
T1	60.6	1.0	...	-7.5	47.6	0.1	-1.9	-0.2	-0.9	11.6	3.8	...	7.1
T2	79.7	1.4	...	-11.0	68.3	1.6	-0.8	0.2	-0.5	7.3	7.2	...	6.0
T3	124.1	1.2	...	-17.1	118.8	3.3	-1.5	-0.3	-0.4	8.6	5.5	...	6.0
2013 T4	47.8	0.1	-0.1	-15.7	69.5	1.4	-5.1	-0.4	0.0	4.6	-10.5	...	4.1
T1	63.3	0.5	-0.4	-10.6	60.8	3.9	-4.1	-0.9	-0.2	5.1	6.0	...	3.1
T2	75.1	0.5	-0.5	-15.8	75.8	-0.2	-2.8	-0.4	...	11.3	2.9	0.4	3.9
T3	138.0	1.4	-0.8	-20.7	145.8	-0.7	-2.7	-0.4	...	8.4	3.6	0.7	3.6
2014 T4	59.5	1.4	-0.8	-25.9	96.4	1.3	-4.4	-0.5	-1.6	-5.3	-4.3	-0.1	3.5
Janar	26.2	0.0	-0.1	-2.6	22.4	2.3	-1.2	-0.8	-0.3	1.8	3.6	0.2	0.9
Shkurt	14.5	0.3	-0.1	-3.5	14.6	1.3	-1.4	0.0	...	1.2	1.2	-0.1	1.0
Mars	22.5	0.3	-0.2	-4.5	23.9	0.3	-1.6	-0.1	0.0	2.0	1.2	0.0	1.3
Prill	32.5	0.1	-0.2	-5.1	28.6	0.3	-0.5	-0.2	0.0	3.7	4.6	-0.1	1.3
Maj	26.2	0.0	-0.1	-5.7	23.6	-0.7	0.4	-0.1	...	4.1	3.5	0.2	1.2
Qershor	16.3	0.4	-0.2	-5.0	23.5	0.3	-2.7	-0.1	0.0	3.5	-5.1	0.3	1.4
Korrik	65.0	0.3	-0.1	-6.9	66.9	-1.0	0.1	-0.3	0.0	2.5	2.2	0.3	1.2
Gusht	47.7	0.4	-0.1	-7.0	49.6	-1.0	-0.6	0.0	...	2.6	2.6	0.2	1.1
Shtator	25.3	0.8	-0.5	-6.7	29.3	1.3	-2.2	-0.1	...	3.4	-1.2	0.2	1.3
Tetor	21.2	0.3	-0.1	-10.8	31.7	0.6	-1.3	-0.1	...	-2.0	1.8	-0.1	1.1
Nëntor	21.9	0.4	-0.1	-4.8	26.3	-0.7	-2.4	-0.4	...	-2.5	5.1	-0.1	1.2
2014 Dhjetor	16.4	0.8	-0.5	-10.3	38.3	1.4	-0.8	0.0	-1.6	-0.8	-11.2	0.0	1.1

Burimi: BQK (2015)

Tabela 2.4. Të ardhurat parësore

(Në milionë euro)

Përshkrimi	Bilanci			Kredi				Debi				
	Kompensimi i punëtorve	Të ardhurat nga investimet	Të ardhurat tjera parësore	Kompensimi i punëtorve	Të ardhurat nga investimet	Të ardhurat tjera parësore	Kompensimi i punëtorve	Të ardhurat nga investimet	Të ardhurat tjera parësore			
2007	186.3	154.9	315	...	239.2	155.6	83.6	...	52.9	0.8	52.2	...
2008	164.0	175.4	-11.4	...	233.3	176.2	57.1	...	69.3	0.8	68.5	...
2009	60.9	168.7	-107.8	...	181.7	169.7	12.0	...	20.7	0.9	19.8	...
2010	67.0	171.6	-104.6	...	186.3	176.1	10.1	...	19.2	4.5	14.7	...
2011	111.3	208.2	-96.9	...	239.1	221.3	17.8	...	27.8	13.1	14.7	...
2012	153.6	214.3	-60.6	...	230.0	219.9	10.1	...	76.4	5.6	70.8	...
2013	121.5	218.9	-97.4	...	227.5	223.2	4.3	...	106.0	4.3	101.6	...
2014	113.8	200.4	-85.9	-0.7	215.8	206.5	8.0	13	102.0	6.1	93.9	2.0
T1	23.8	45.6	-21.8	...	48.5	46.5	2.1	...	24.7	0.9	23.8	...
T2	18.8	41.9	-23.1	...	44.2	42.7	1.4	...	25.4	0.9	24.5	...
T3	1.1	40.3	-39.2	...	44.6	41.8	2.7	...	43.5	1.5	42.0	...
2010 T4	23.3	43.9	-20.5	...	49.0	45.1	3.9	...	25.6	1.2	24.4	...
T1	41.3	50.2	-8.9	...	56.1	52.6	3.5	...	14.8	2.4	12.4	...
T2	28.4	55.7	-27.3	...	63.2	58.8	4.5	...	34.8	3.0	31.8	...
T3	21.2	54.2	-33.0	...	62.4	57.5	4.8	...	41.2	3.3	37.8	...
2011 T4	20.4	48.1	-27.7	...	57.3	52.3	5.0	...	37.0	4.3	32.7	...
T1	37.4	53.1	-15.7	...	59.3	55.6	3.7	...	21.9	2.5	19.4	...
T2	43.9	53.6	-9.6	...	57.9	55.2	2.7	...	13.9	1.6	12.4	...
T3	20.3	53.1	-32.8	...	56.4	53.7	2.7	...	36.1	0.7	35.4	...
2012 T4	51.9	54.5	-2.5	...	56.4	55.4	1.0	...	4.5	0.9	3.5	...
T1	42.4	55.4	-13.0	...	57.3	56.0	1.2	...	14.9	0.6	14.2	...
T2	32.5	52.8	-20.3	...	55.4	53.9	1.5	...	22.9	1.1	21.7	...
T3	2.1	53.8	-51.8	...	55.3	54.9	0.4	...	53.3	1.1	52.2	...
2013 T4	44.6	56.9	-12.3	...	59.5	58.4	1.1	...	15.0	1.5	13.5	...
T1	31.4	46.1	-14.8	...	49.6	48.1	1.5	...	18.2	2.0	16.2	...
T2	31.4	49.9	-18.6	0.1	53.2	50.8	1.9	0.5	21.8	0.9	20.5	0.4
T3	23.5	54.2	-30.8	0.1	58.9	55.2	3.2	0.5	35.4	1.0	34.0	0.4
2014 T4	27.5	50.2	-21.8	-0.9	54.2	52.4	1.5	0.3	26.6	2.2	23.3	1.2
Janar	11.8	14.9	-3.1	...	15.6	15.2	0.5	...	3.8	0.3	3.6	...
Shkurt	13.1	15.9	-2.8	...	16.8	16.3	0.5	...	3.7	0.4	3.3	...
Mars	6.5	15.3	-8.8	...	17.2	16.7	0.5	...	10.6	1.3	9.3	...
Prill	13.3	16.3	-3.0	0.0	17.1	16.5	0.5	0.1	3.9	0.2	3.5	0.2
Maj	9.2	16.1	-7.0	0.1	17.3	16.4	0.6	0.2	8.1	0.3	7.7	0.1
Qershor	9.0	17.5	-8.6	0.0	18.8	17.9	0.7	0.2	9.8	0.4	9.3	0.1
Korrik	11.1	18.5	-8.5	0.1	21.1	19.9	0.9	0.3	10.0	0.4	9.4	0.2
Gusht	7.3	16.0	-8.7	0.0	17.5	16.3	1.1	0.1	10.3	0.3	9.8	0.2
Shtator	5.1	18.8	-13.7	0.0	20.3	19.1	1.1	0.1	15.2	0.3	14.8	0.1
Tetor	13.1	17.7	-4.6	0.0	18.7	18.0	0.5	0.1	5.6	0.3	5.2	0.1
Nëntor	4.9	13.0	-7.4	-0.8	15.1	14.5	0.5	0.1	10.2	1.4	7.8	0.9
2014 Dhjetor	9.5	19.4	-9.8	-0.1	20.4	19.9	0.5	0.0	10.9	0.4	10.3	0.1

Burimi: BQK (2015)

Tabela 2.5. Të ardhurat dytësore

(Në milionë euro)

Përshkrimi	Të ardhurat dytësore			Kredi			Debi		
	Qeveria	Korporatat financiare, korporatat jo financiare, ekonomitë familjare, dhe OJSHEF-të		Qeveria	Korporatat financiare, korporatat jo financiare, ekonomitë familjare, dhe OJSHEF-të		Qeveria	Korporatat financiare, korporatat jo financiare, ekonomitë familjare, dhe OJSHEF-të	
2007	842.0	245.1	596.9	935.2	251.4	683.8	93.1	6.3	86.8
2008	873.2	223.5	649.7	972.3	223.5	748.8	99.1	...	99.1
2009	983.4	322.9	660.5	1106.8	322.9	783.9	123.4	...	123.4
2010	982.5	319.5	662.9	1087.4	319.5	767.9	105.0	...	105.0
2011	1021.1	322.2	698.9	1133.6	322.2	811.4	112.5	...	112.5
2012	1192.5	401.6	791.0	1296.4	401.6	894.9	103.9	...	103.9
2013	1222.4	341.9	880.5	1304.0	341.9	962.0	81.6	...	81.6
2014	1171.9	291.9	880.0	1270.3	291.9	978.4	98.4	0.0	98.4
T1	195.3	65.2	130.1	221.0	65.2	155.8	25.7	...	25.7
T2	228.6	72.3	156.3	253.3	72.3	181.0	24.7	...	24.7
T3	260.2	65.7	194.4	286.5	65.7	220.8	26.3	...	26.3
2010 T4	298.4	116.4	182.0	326.7	116.4	210.3	28.3	...	28.3
T1	227.9	79.4	148.5	255.1	79.4	175.7	27.2	...	27.2
T2	251.7	86.6	165.1	280.8	86.6	194.2	29.1	...	29.1
T3	276.4	81.7	194.7	304.6	81.7	222.9	28.2	...	28.2
